

PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

2021-2025

(RISHIKUAR)

BASHKIA MAT

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	6
II.	PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL	7
III.	PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME.....	11
3.1	VENDNDODHJA DHE DEMOGRAFIA.....	11
3.2	BURIMET NATYRORE	12
	Zonat e Mbrojtura	12
3.3	ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK.....	15
3.4	NIVELI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	15
3.4.1	Burimet njerëzore	17
3.4.2	Mjetet.....	18
3.5	VENDEPOZITIMET	20
3.5.1	Venddepozitimi ekzistues	20
3.5.2	Venddepozitimi i ri në Bashkinë Mat	22
3.6	INVENTARIZIMI DHE DIGJITALIZIMI I ASETVEVE TË SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	23
3.6.1	Evidentimi i Bizneseve Gjeneruese të Mbetjeve të Riciklueshme	26
3.6.2	Mundësitë për rikuperimin/co-procesimin e mbetjeve.....	27
3.7	KONKLUZIONE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË E MATIT	28
IV.	ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE	28
4.1	ANALIZA FINANCIARE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE	28
4.2	TARIFAT AKTUALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	29
4.2.1	Tarifat e menaxhimit të mbetjeve për kategorinë biznes	29
4.2.2	Tarifa e Menaxhimit të Mbetjeve Familjare	34
4.2.3	Konkluzione	35
4.3	TARIFIMI PROGRESIV SIPAS LIGJIT	35
4.3.1	Përqasja që sjell modeli	35
4.3.2	Shpjegimi i faktorëve	39
4.3.3	Përlllogaritja e tarifës.....	55
4.4	KOSTIFIKIMI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	56

4.4.1	Metodologjia mbi kostifikimin e shërbimit.....	56
4.4.2	Problematika	56
4.4.3	Rezultatet.....	58
4.5	SKEMAT E MENAXHIMIT TË MBETJEVE	59
V.	PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	65
5.1	VIZIONI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE PËR BASHKINË MAT.....	65
5.2	OBJEKTIVAT KRYESORË TË PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE, BASHKIA MAT	65
5.3	OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PLANIT.....	65
5.4	RREGULLORE BASHKIAKE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE	66
5.4.1	Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve	70
5.4.2	Veçimi, sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve urbane	71
5.4.3	Grumbullimi, largimi e transportimi i mbetjeve	73
5.4.4	Tarifat	77
5.4.5	Ndalimet, kontrolli dhe sanksionet	77
5.4.6	Marrëdhëniet me publikun.....	79
VI.	PLANI I VEPRIMIT	82
6.1	FAZIMI I PLANIT TË VEPRIMIT	82
	SHTOJCA 1: HARTAT E PGM, SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE	85
	SHTOJCA 2: SKEMAT E PASTRIMIT TË RRUGËVE	90
	SHTOJCA 3: GRAFIKËT E MBULIMIT ME SHËRBIM TË POPULLSISË	91
	SHTOJCA 4 : FISHAT E PROJEKTEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT	93
	SHTOJCA 5: RIKUPERIMI I ENERGJISË (LËNDËT DJEGËSE ALTERNATIVE RDF DHE SRF) ...	97

Lista e Figurave

Figura 1	Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve	8
Figura 2:	Harta administrative e Bashkisë Mat.....	11
Figura 3	Parku Kombëtar Zall Gjocaj.....	12
Figura 4	Parku Kombëtar Qafë Shtamë.....	13
Figura 5	Liçeni i Ulzës	14
Figura 6	Pamje gjatë pastrimit të Hot-spoteve	16

Figura 7 Përçinda e Mbulit me Shërbim sipas NjA.....	17
Figura 8 Organigrama.....	17
Figura 9 a)Kontenierë, Burrel	b)Kontenierë periferi..... 18
Figura 10 Kontenierë 0.09m ³ Kontenierë 0.07m ³	18
Figura 11 Mjeti teknologjik 12 ton.....	19
Figura 12 Mjeti tekologjik 7 ton.....	19
Figura 13 Vendndodhja e Vend-Depozitimit.....	21
Figura 14 Gjendja Aktuale e Vend-Depozitimit.....	21
Figura 15 Venddepozitimi nën rikonstruksion.....	22
Figura 16 Harta e PGM, NjA Burrel.....	24
Figura 17 Harta e Shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve, Qyteti i Burrelit.....	24
Figura 18 Harta e Shpërndarjes së Kontenierëve 0.07 dhe 0.09m ³ , Qyteti i Burrelit.....	25
Figura 19 Harta e Aktivitetve Gjeneruese.....	26
Figura 20 Numri i kontenierëve të nevojshëm në Bashkinë Mat.....	58
Figura 21 Raporti i Kostos së Menaxhimit të Mbetjeve.....	58
Figura 22 Skema e Menaxhimit të Mbetjeve.....	60
Figura 23 Hartat e PGM NjA, Lis.....	85
Figura 24 Harta e PGM, NjA. Macukull.....	86
Figura 25 Harta e PGM, NjA. Rukaj.....	86
Figura 26 Harta e PGM, NjA.Ulëz.....	87
Figura 27 Harta e PGM, NjA.Baz.....	87
Figura 28 Harta e PGM, NjA. Derjan.....	88
Figura 29 Harta e PGM, NjA. Komsit.....	88
Figura 30 Skema e Pastrimit të Rrugëve, Burrel.....	90
Figura 31 Sipërfaqet e Planifikuara për Pastrim në vitin 2022.....	90
Figura 32 Grafiku i Mbulimit me Shërbim të Popullsisë.....	91

Lista e Tabelave

Tabela 1 Tabela e distancave të përshkruara nga mjetet.....	20
Tabela 2 Numri i Bizneseve.....	26
Tabela 3 Niveli i tarifës së pastrimit për kategoritë e bizneseve.....	30
Tabela 4 Tabela e gjobave për kundravajtjet administrative në mjedis.....	35
Tabela 5 Parimet kryesore që respekton modeli tarifor.....	36
Tabela 6 Përcaktimi i kategorive dhe parametrave që do të influencojnë tarifën për çdo klient (=“malus”).....	38
Tabela 7 Përlogaritja e faktorit të madhësisë.....	39
Tabela 8 Tabela e faktorizimit për oborret.....	40
Tabela 9 Modeli propozon ndikimin e faktorit madhësi në logaritjen e tarifës.....	40
Tabela 10 Mënyra si bëhet përlogaritja e kriterit të madhësisë për familje në Excel.....	40
Tabela 11 Mënyra si bëhet përlogaritja e kriterit të madhësisë për biznese në Excel.....	52
Tabela 12 Përcaktimi i faktorëve të faturimit për secilin klient.....	54
Tabela 13 Përlogaritja e tarifës për çdo klient (shembull).....	55
Tabela 14 Normat e gjenerimit të mbetjeve, Bashkia Mat.....	56
Tabela 15 Tabela e numrit të popullsisë, Bashkia Mat.....	57
Tabela 16 Tabela e gjenerimit të mbetjeve, Bashkia Mat.....	57
Tabela 17 Programet dhe projektet e zhvillimit dhe plani i veprimit.....	84

SHKURTIME

PGM	Pikë Grumbullimi Mbetjesh
MFE	Formula e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
VKM	Vendim i Këshilit të Ministrave
MF	Mbetjet nga Familjet
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
PLMIMNU	Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
SKM	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
BE	Bashkimi Evropian
PKMM	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
LDA	Lëndë Djegëse Alternative
RDF	Refused Derived Fuel / Lëndë djegëse me prejardhje të refuzuar
SRF	Solid Recoved Fuel / Lëndë e rikuperuar e ngurtë

I. HYRJE

Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Mat. Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në adresimin e sfidës tanimë disavjecare që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit. Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve si dhe përmbushja e ligjit kuadër të mbetjeve dhe kërkesave përkatëse;
- Opsionet e manaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e manaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e manaxhimit të mbetjeve;
- Nevojat për përmirësimin e infrastrukturës të shërbimit dhe trajtimit të mbetjeve në të gjithë territorin;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

II. PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL

Pavarësisht cilësisë dhe problemeve që lidhen me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, kuadri ligjor ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve ka qenë vazhdimisht në përmirësimin, dhe gjatë dhjetë viteve të fundit, ligjet e shumta, dekretet dhe udhëzimet që janë miratuar janë përshtatur me Direktivat e BE-së dhe kërkesat e Konventës së Bazelit.

Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Referuar ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 27.5.2020 Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035, jepen drejtimet kryesor të politikës së Qeverisë Shqiptare për minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri.


Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM 2020-2035). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Shtyllat politike janë si në vazhdim:

- Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;
- Edukimi: Partnerët/bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;
- Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrë të duhur;
- Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.
- Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në krye dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.

Figura 1 Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve



Burimi: Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve tregon një renditje preference për veprimet e reduktimit dhe menaxhimit të mbetjeve dhe zakonisht paraqitet në me një diagramë në formën e një piramide. Hierarkia kap progresin e një materiali ose produkti përmes fazave të njëpasnjëshme të menaxhimit të mbetjeve dhe përfaqëson pjesën e fundit të ciklit jetësor për çdo produkt. Qëllimi i hierarkisë së mbetjeve është të nxjerrë përfitimet maksimale praktike nga produktet dhe të gjenerojë sasinë minimale të mbetjeve.

Rikuperimi në piramiden e hierarkisë qëndron përpara depozitimit, kjo pasi disa nga produktet të cilat kanë kaluar më herët etapat e trajtimit të mbetjeve bartin energji kalorifike e cila mund të ekstrahohet nëpërmjet bashkë-procesimit (**Shtojca nr.5**). Si përfundim, depozitimi i këtyre mbetjeve nënkupton zhvlerësimin me vetëdije të kapacitetit termik të këtyre materialeve duke refuzuar kontributin ekonomik që ato mund të japin si Lëndë Djegëse Alternative.

Rikuperimi i energjisë është një opsion mjaft i favorshëm për reduktimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfill si dhe në përmirësimin e performancës mjedisore për sa i përket procesit të menaxhimit të mbetjeve.

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit përcakton politikat e menaxhimit të programit të mbetjeve, që synojnë zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas direktivave të BE-së, zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe lokale.

Sfidat kryesore që do të adresohen, siç është përcaktuar nga strategjia përfshijnë:

- a) Miramitimi i strategjive kombëtare sektoriale,

- b) Përmirësimi i kapaciteteve të monitorimit të cilësisë së mjedisit,
- c) Financimi i investimeve madhore,
- d) Krijimi i planifikimit strategjik sistematik për ndryshimet klimatike.

Brenda harkut kohor të zbatimit, strategjia synon arritjen e objektivave të mëposhtme:

- a) Ulja me 25% e mbetjeve që janë depozituar në depozita / landfill-e
- b) Riciklimit deri në 75% të mbetjeve bashkiake
- c) Hartimi i planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve dhe zhvillimin e landfill-eve rajonale

Objektivat e Strategjisë në afatgjatë (2020 - 2035), përfshijnë ndërtimin e landfill-eve në të gjitha qarqet dhe mbyllja e landfilleve bashkiake në mbarë vendin me financimin e buxhetit të shtetit, si dhe krijimi i sistemeve të grumbullimit të ndarë që do të çojnë drejt një reduktim deri në 25% të mbetjeve të depozituara në landfill dhe riciklimin deri në 75% të totalit të mbetjeve bashkiake.

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, nr. 10 463, datë 22.09.2011, i ndryshuar, është aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të shtatorit 2011. Ligji adapton plotësisht shumicën e direktivave dhe rregulloret e BE-së, dhe siguron bazën e duhur ligjore për përshtatjen e plotë të gjithë legjislacionit të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Përgjegjësia për Menaxhimin e Mbetjeve

Neni 10 i Ligjit parashikon se Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve miratohet në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Planeve Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Neni 15 parashikon se Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të krijohet në nivel kombëtar, dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve në shkallë kombëtare.

Neni 20 përcakton se shpenzimet për menaxhimin e integruar të mbetjeve mbulohen bazuar në parimin "ndotësi paguan", përveç rastit kur Këshilli i Ministrave apo këshillat vendore vendosin që pjesë të koston apo gjithë koston mbulohen nga të tjerë që nuk janë gjeneruesit fillestare të mbetjeve.

Për më tepër i njëjti ligj parashikon ndarjen e autoritetit, funksionet, rolet dhe përgjegjësitë, nga lartë - poshtë, nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore. Në veçanti, ligji ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me sa më poshtë:

- I. Të miratojë një plan të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut,
- II. Të miratojë rregullat e kontrollit të menaxhimit të mbetjeve të veçanta, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, ushqim dhe kontejnerëve të pijeve, metalin, plastikën apo mbetjet e oborrit,
- III. Të raportojë çdo vit në qarkun përkatës dhe institucione të tjera për zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve vendore,
- IV. Të publikojë një draft të Planit dhe ta vere atë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të qeverisjes vendore,
- V. Të miratojë Planin përkatës duke marrë në konsideratë rezultatet e çdo Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), përpara miratimit të saj.

Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

VKM nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035"

VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane"

VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"

VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"

VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e 15 mbetjeve të PCB-ve të përdorura "

VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura" VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "

VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"

VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"

VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"

VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"

VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"

VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qeni mbetje"

VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"

VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"

VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"

VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"

VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"

VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"

VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"

VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeteve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"

VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"

VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"

Udhëzime


Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 VENDNDODHJA DHE DEMOGRAFIA

Bashkia Mat ndodhet në pjesën qendrore të Republikës së Shqipërisë, është e përbërë nga 8 njësi administrative, Burrel, Komsj, Lis,Rukaj, Baz, Ulëz, Macukull, Derjan dhe 47 fshatra. Kjo Bashki (pas ndarjes së re territoriale) ka një sipërfaqe totale prej 493km² dhe kufizohet nga Bashkitë Mirditë, Kurbin, Krujë, Klos dhe Dibër. Sipas regjistrimit të vitit 2011 (CENSUS), Bashkia numëron 27,857 banorë ndërsa sipas regjistrimit të Gjendjes Civile (RC) ajo ka një popullsi prej 36,552 banorë dhe një densitet prej 63 banorë / km².

Figura 2: Harta administrative e Bashkisë Mat



Burimi: CO-Plan. 2022

3.2 BURIMET NATYRORE

Zonat e Mbrojtura

Territori i Bashkisë Mat ka larmishmëri të relievit dhe burime të shumta natyrore. Sistemi natyror zë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë dhe pjesë e saj janë 20 monumente natyre, 3 prej të cilave janë zonat e mbrojtura të kategorisë së II-të dhe IV-të:

- **Parku Kombëtar Zall Gjocaj** ndodhet 40 km në veri-lindje të qytetit të Burrelit me një sipërfaqe prej 140ha. Ky park ka vlera të mëdha peisazhistike dhe turisitke, gjithashtu në territorin e tij pyje pishe, arre, përrenj të shumtë si dhe një shumëllojshmëri e florës dhe faunës.

Figura 3 Parku Kombëtar Zall Gjocaj



Burimi: aboutalbania.eu

- **Parku Kombëtar Qafë Shtama** ka një sipërfaqe prej 20km² dhe ndodhet në kufirin jug-perëndimor të Bashkisë. Zona është e njohur për vlerat natyrore, pyjet e virgjër dhe burimet me vlera kuruese.

Figura 4 Parku Kombëtar Qafë Shtamë



Burimi: discoverdinarides.com

- **Parku Rajonal i Liqenit të Ulzës** ndodhet në veri-perëndim të qytetit të Burrelit me një sipërfaqe prej 4.206ha. Në këtë park ndodhet liqeni i Ulzës dhe i Shkopetit, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekoturizmit dhe konservimin e biodiversitetit.

Figura 5 Liqeni i Ulzës



Burimi: googleimages.com

- **Gjeomonumente (Kategoria III)**
 - Guri i Gjatë-Urxall
 - Kepi i Skënderbeut Varosh
 - Kanioni i Urakës
 - Rrapi i Marqethit
 - Lisi i Qershizës
 - Maja e Boshtresë
 - Gurri i Vashës
 - Lisi i Tushës
 - Kanioni i Filmit
 - Tisat e Mbasdejës
 - Burimi i Shutresë
 - 4 lisa dhe 1 rrap shumëvjeçarë

3.3 ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK

Profili ekonomik i bashkisë është kryesisht bujqësor. Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit krijon kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë. Qyteti i Burrelit u ndërtua i lidhur me industrinë e pasurimit të kromit, e cila është aktualisht në proces për riaktivizim. Gjithsesi kjo industri nuk është në gjendje të kthehet në burim të rëndësishëm punësimi për qytetin, që aktualisht ka rreth 11 mijë banorë. Burimet financiare në dispozicion për banor në Bashkinë e Matit janë në nivelin kombëtar mesatar.

3.4 NIVELI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nga 1 Janari i vitit 2022 shërbimi i pastrimit në bashkinë Mat është detyrë e Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve me **Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.688 Prot datë 31.12.2021** për krijimin e strukturës së Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve, sektor i krijuar posaçërisht për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Mat. Ky sektor ka për detyrë që të menaxhojë të gjithë procesin e menaxhimit të mbetjeve që në burim deri në transportimin e mbetjeve në venddepozitim. Aktualisht, grumbullimi i mbetjeve në Bashkinë Mat kryhet në Njësine Administrative Burrel dhe i shërben dhe gjithë fshatrave përgjate akseve rrugore të asfaltuara. Akset : Ura Luses –Burrel, Ura e Lis-Burrel, Komsit-Burrel, Tuneli i Shkopetit –Ulez-Burrel. Mbetjet depozitohen në venddepozitim të miratuar pranë njësisë Administrative Komsit ku mbetjet vetëm depozitohen dhe mbulohen me dhe. Venddepozitimi aktual i mbetjeve është në fazë rehabilitimi nga investimi që po kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me kontratën **Nr.333/5 Prot datë 25.06.2021** me objekt “Mbyllja ,rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel,Kukës, Libohov, Përmet, Krujë) të lidhur ndërmjet “Alba Konstruksion” sh.p.k dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Aktualisht nuk ka hotspote të hapura të mbetjeve, pasi 30 prej tyre janë trajtuar përgjatë aksionit të ndërmarrë nga stafi i sektorit të menaxhimit të mbetjeve të kësaj bashkie.

Figura 6 Pamje gjatë pastrimit të Hot-spoteve



Burimi: Bashkia Mat


Bashkia Mat aktualisht mbulon 59% të popullsisë me shërbim. Përkatësisht Njësia Administrative Burrel 100% , NjA. Ulëz 80% janë njësitë me përqindjen më të lartë të mbulimit me shërbim ndërsa NjA. Derjan dhe Macukull kanë përqindjen më të ulët të mbulimit me shërbim me vetëm 20% të popullsisë. Gjatë aksionit të ndërmarrë nga bashkia në muajin Gusht të vitit 2022 janë shpërndarë 30 kontenierë me vëllim 1.1m³ në njësitë administrative Komsj, Lis, Rukaj, Derjan dhe Macukull, ku dy të fundit kanë përqindjen më të ulët të mbulimit me shërbim. (Shih Figura 4)

Frekuenca e ofrimit të shërbimit përmes mbledhjes së mbetjeve është 7 herë në javë për zonën urbane dhe 2 herë në javë për zonën rurale. Shërbimi kryhet përmes 231 kontenierëve, me një vëllim prej 1.1 m³, të shpërndarë në densitet më të lartë në zonat urbane dhe me densitet më të ulët në zonat rurale. Dendësia e ulët e kontenierëve në zonat rurale dhe frekuenca e ulët e shërbimit (2 herë në javë) vlerësohet si një cilësi e ulët shërbimi për banorët e këtyre zonave, veçanërisht për zonat rurale ku pikat e grumbullimit janë larg banesave periferike (frekuenca e ulët ka të bëjë me sasinë më të vogël të mbetjeve në zonat rurale). Në territorin e Bashkisë Mat nuk aplikohen forma të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Disa pika të grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale janë në qendrat e fshatit ose në rrugët e aksesueshme me anë të mjeteve të transportit të mbetjeve, dhe lënë jashtë shërbimit disa shtëpi në distanca të konsiderueshme nga këto pika. Por vendosja e pikave të grumbullimit dhe më afër shtëpive më të largëta do të çonte në rritje të kostos së shërbimit dhe detyrimisht dhe në rritje të tarifës duke e bërë të papërbalueshme për familjet në zonat rurale. Mbetjet e gjeneruara dhe trajtuara në vit në Bashkinë e Matit janë 4,423 ton.

Shkalla e gjenerimit të mbetjeve është deklaruar përkatësisht 0.6 kg/banor/ditë për zonën urbane, 0.4 kg/banor/ditë për zonat paraurbane dhe zona rurale 0.3 kg për frymë. Nga llogaritja e vëllimeve të deklaruara të mbetjeve në numrin e banorëve, norma gjeneruese ka një mesatare prej rreth 0.4-0.6 kg/banor në ditë për të gjithë territorin (rurale dhe urbane pasi në sasinë e deklaruar prej 16,453 t/vit janë llogaritur dhe mbetjet e krijuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë.

Figura 7 Përqindja e Mbulit me Shërbim sipas NjA.




Burimi: CO-Plan, 2022

3.4.1 Burimet njerëzore

Në Bashkinë Mat shërbimi kryhet nëpërmjet strukturave të vetë bashkisë, nëpërmjet Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve. Ky sektor është i përbërë nga një personel prej **20** punonjësish **1** përgjegjës sektori, **1** brigadier si dhe një grup pune prej **18** punonjësish nga të cilat **4** janë shoferë, **6** punëtor transporti dhe **8** punëtor pastrimi të cilët janë të angazhuar për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, largimit dhe grumbullimit të mbetjeve. Organigrama është paraqitur në figurën e mëposhtme.

Figura 8 Organigrama



Burimi: Bashkia Mat, Përpunoi: CO-Plan, 2022

3.4.2 Mjetet

Kontenierët

Bashkia Mat ka në përdorim **231** kontenierë me vëllim 1.1m^3 dhe **106** kontenierë 0.07m^3 dhe 0.09m^3 . Siç mund të shikohet në figurën e mëposhtme në qytetin e Burrelit janë shpërndarë kontenierë të rinj metalikë dhe në gjendje me të mirë krahasuar me kontenierët e shpërndarë në njësitë e tjera administrative. Sipas konstatimeve në terren nuk kryhet mbulimi i kontenierëve me kapakët përkatës edhe pse janë të pajisur me to, gjë që sjell përhapjen e aromave të pakëndshme në ajër. Në disa raste nuk ka xhepa të posaçëm për kontenierët dhe vendosja e tyre në hapësirën e karrexhatës përbën problem për qarkullimin e mjeteve të transportit.

Figura 9 a)Kontenierë, Burrel



Burimi: Bashkia Mat

b)Kontenierë në periferi




Figura 10 Kontenierë 0.09m^3

Kontenierë 0.07m^3



Burimi: CO-Plan, 2022



Kamionët

Bashkia Mat ka në pronësi 2 kamionë teknologjik. Mjeti i llojit DAF ka një kapacitet prej 12 ton ndërsa mjeti i llojit IVECO ka një kapacitet prej 7 ton. Të dy mjetet janë funksionale dhe në gjendje të mirë pune.

Figura 11 Mjeti teknologjik 12 ton



Burimi: Bashkia Mat



Figura 12 Mjeti tekonologjik 7 ton



Burimi: Bashkia Mat

Të dhënat e llogaritura për distancat që përshkruajnë mjetet e transportit të mbetjeve janë nxjerrë nga sistemi GIS, ku janë informatizuar të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) dhe itineraret që përshkruajnë mjetet e grumbullimit. Në *Figurën 14* janë të paraqitur itineraret që ndjekin mjete pët të kryer grumbullimin e mbetjeve. Të dhënat janë të pasqyruara si më poshtë:

Tabela 1 Tabela e distancave të përshkruara nga mjetet

Zonat	Qyteti Burrel	Nj. A. Rurale
Distanca e përshkruar nga të gjitha mjetet për grumbullim në km/ditë	30	60
Mesatarja e përshkruar nga secili mjet në km/ditë	10	50
Distanca mesatare e përshkruar nga secili mjet deri në vend-depozitim	3	20

Burimi: Bashkia Mat, 2020

3.5 VENDEPOZITIMET

3.5.1 Venddepozitimi ekzistues

Në rastin e vend-depozitimit të Matit, nuk ka ndërhyrje për uljen e ndotjes së gazit metan i lëshuar në atmosfere i cili kontribuon si një gaz serë dhe po ashtu ndot me aromën e saj të fortë.

Venddepozitimi është gjithashtu problematik për shkak të djegies së mbetjeve plastike në zonë. Ky vend-depozitim nuk ka status ligjor si një landfill.

Venddepozitimi i mbetjeve në Mat me koordinata "Venddepozitimi x-416670.58 y-4605560.77" funksionon në kushte shumë të vështira teknike dhe mjedisore dhe gjithashtu pranë zonave të banuara. Ky venddepozitim është i hapur me Vendimin e KKRRTnr. 34, datë 18.09.1996 Venddepozitimi, nuk ka kriteret operative dhe nuk është i pajisur me rrjetin e kanalizimit për disiplinimin e ujërave sipërfaqësore. Nga ana

e Bashkisë së Matit është vendosur funksionimi aktiv i këtij venddepozitimi për shkak të kapacitetit që ka dhe se venddepozitimet e tjera në Njësitë Administrative kanë kapacitete të kufizuara dhe kushte edhe më të këqija. Venddepozitimi me sipërfaqe prej 19 131 m² u miratua me vendimin e keshlliti të Rrethit nr.6 datë 15.08.1997. Venddepozitimi ndodhet në zonë fushore larg nga zonat e banuara.

Figura 13 Vendndodhja e Vend-Depozitimit



Burimi: CO-Plan, 2022

Figura 14 Gjendja Aktuale e Vend-Depozitimit



Burimi: CO-Plan, 2022

3.5.2 Venddepozitimi i ri në Bashkinë Mat

Pas zbatimit të reformës territoriale të vitit 2015, përveç problematikave dhe sfidave të tjera të menaxhimit të shërbimeve, një sfidë shumë e madhe ishte dhe menaxhimi i venddepozitimeve të shumta që funksiononin në pjesën më të madhe të ish-komunave, tashmë Njësi Administrative. Në të gjitha Njësitë Administrative funksiononte nga një venddepozitim me vendime të ish-Këshillave të Komunave ku miratohej sipërfaqja respektive si zonë e depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane por funksiononin pa u pajisur me lejet përkatëse të përcaktuara në legjislacion. Nga kontrollet e kryera në terren u konstatua se në një pjesë e mirë e këtyre Njësive Administrative, venddepozitimet nuk ishin aktivë.

Fillimisht nga ana e Bashkisë së re Mat u vendos që për depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane në territorin e bashkisë të përdorej venddepozitimi në qytetin e Burrelit. Edhe pas kësaj vendimmarrjeje gjëndja nuk ishte e kënaqshme dhe për këtë arsye në fillim të vitit 2018 kur Ministria e Mjedisit dhe Turizmit mori nismën për “Zbutjen e Riskut në Venddepozitime”, u bë rivlerësimi i situatës. Grupi i punës i ngritur për studimin e venddepozitimeve në Bashkinë Mat propozoi lënien aktive vetëm të një venddepozitimi në Burrel. Edhe ky venddepozitim nuk plotëson kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 452 datë 11.07.2012 “Për Landfillet e Mbetjeve” të ndryshuaras. Megjithatë për shkak të kapacitetit të tij të konsiderueshëm krahasuar me të tjerët si zgjidhja e vetme në këtë moment është vendosur të funksionojë deri në zgjidhjen afatgjatë duke respektuar legjislacionin dhe mjedisin.

Vend-depozitimi Bashkia Mat ka një sipërfaqe prej 19 131 m². Në këtë sipërfaqe depozitohen mbetjet e 8 Njësive Administrative.

Figura 15 Venddepozitimi nën rikonstrukcion



Burimi: Bashkia Mat

Nga analizat e specialistëve (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2018) si dhe në zbatim të legjislacionit për “Menaxhimin e Mbetjeve” (VKM, 2011), të gjitha venddepozitimet në Njësitë Administrative zonat rurale të mbyllura tashmë, duhet të sistemohen pasi paraqesin rrezik mjedisor për banorët dhe aktivitetet bujqësore në afërsi.

Pavarësisht destinacionit që do marrë vend depozitimi ekzistues duhet domosdoshmërisht të merren në konsideratë fakti se është emergjente marrja e masave të mëposhtme;

- Zhvendosje /sistemim i mbetjeve.
- Ngritje e rrethimit.
- Instalim të portës hyrëse.
- Mbrojtje ndaj zjarrit.
- Drenazhim.
- Ndërtim i filtrave natyrorë.
- Largim i gazit.

Propozimet e mësipërme kërkojnë edhe analizë më të thelluar për studime fizibiliteti dhe projekt teknik.

Në kuadër të këtyre masave aktualisht në afërsi të vendpozitimit ekzistues po kryhen punimet për përfundim in e vendpozitimit të ri

3.6 INVENTARIZIMI DHE DIGJITALIZIMI I ASETVE TË SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Në kuadër të punës për hartimin e planit vendore për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Mat janë bërë një sërë analizash në programin e GIS. Digjitalizimi ishte procesi nga i cila u nis puna ku filluam me evidentimin e vend-depozitimve të mbetjeve, PGM-ve dhe itinerareve të cilat janë thelbësore në një proces planifikimi. Ishte me rëndësi që çdo aset në funksion të këtij shërbimi publik të evidentohej, të inventarizohej dhe të vendosej në pozicionin gjeografik të saktë.

Ky proces është shumë i rëndësishëm si për të krijuar fillimisht një databazë, e cila mungonte në arkivat e bashkisë, por edhe për të filluar të planifikojnë në të ardhmen në mënyrë sa më të qëndrueshme. Ky proces zgjat në kohë por është i domosdoshëm pavarësisht dinamikave që ndodhen në bashki. Pas grumbullimit të të dhënave nga terreni në forma të ndryshme, si:

- Nëpërmjet aplikacionit 'Geo tracker'
- Nëpërmjet evidentimit në hartë të printuar
- Por edhe me konsultimet me stafin që punon dhe operon në terren

U mundësua më tutje të realizohej edhe digjitalizimi i të dhënave në sistemin GIS.


Digjitalizimi është një proces i rëndësishëm jo vetëm për projektin por është për krijimin e një databaze në menyrë që bashkia në të ardhmen të plotesojë dhe menaxhojë më mirë mbetjet në territorin e saj.

Duke u bazuar në digjitalizimin e të dhënave të mbetjeve në Bashkinë Mat janë evidentuar:

- 231 kontenierë (102 qyteti i Burrelit + 129 në 5 Nj.Administrative) ku të gjitha janë me kapacitet 1.1 m³
- Itinerari që përshkruajnë mjetet teknologjike rreth 70 km linear duke përfshirë të gjithë territorin
- Ka vetem 1 vend-depozitim të mbetjeve të shpërndara në territor .
- Parkimi i mjeteve teknologjike ndodhet afër qendrës së qytetit
- 106 kosha të vegjël urban të shpërndarë në qytetin e Burrelit.
- 30 hotspote të mbyllura nga Bashkia Mat.


Në figurën 13 janë paraqitur pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) dhe shërbimi i menaxhimit të mbetjeve për njësinë administrative Burrel. Sipas evidentimit dhe dixhitalizimit rezulton së në këtë njësi administrative ka 102 kontenierë me kapacitet mbajtës 1.1m^3 , kryesisht të shpërndara në qytetin e Burrelit, pasi aty është përqëndrimi më i lartë i popullsisë dhe bizneseve. Në figurën 15 është paraqitur shpërndarja e kontenierëve 0.07 dhe 0.09m^3 , ku vihet re përqëndrimi i tyre përgjatë akseve kryesore dhe mungesa e tyre në pjesët e tjera të qytetit. Në [Shtojca1](#) paraqiten hartat e pikave të grumbullimit për njësitë e tjera administrative të Bashkisë Mat, ku mund të shihet se njësitë Derjan dhe Macukull kanë shpërndarjen më të ulët të pikave të grumbullimit.

Figura 16 Harta e PGM, NjA Burrel




Burimi: CO-Plan, 2022

Figura 17 Harta e Shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve, Qyteti i Burrelit



Burimi: CO-Plan, 2022

Figura 18 Harta e Shpërndarjes së Kontenierëve 0.07 dhe 0.09m³, Qyteti i Burrelit



Burimi: CO-Plan, 2022

3.6.1 Evidentimi i Bizneseve Gjeneruese të Mbetjeve të Riciklueshme


Në figurën 16 është paraqitur vendndodhja e aktivitetve kryesore për gjenerimin e mbetjeve në Bashkinë Mat. Përqëndrimi më i madh i këtyre aktiviteteve është në qytetin e Burrelit, dhe shume më i ulët në njësitë administrative Ulëz, Baz, Komsit dhe Lis. Qëllimi i evidentimit është krijimi i një skeme menaxhimi për diferencimin e mbetjeve që mund të përdoren si prodhim energjie alternative. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur bizneset sipas kategorive. Gjithsej janë evidentuar 55 biznese nga të cilat **marketet** dhe **auto-serviset** përbëjnë pjesën më të madhe. Mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti i tyre janë të tipit **kartona, plastikë, alumin, gomë, lëndë djegëse (vajra të përdorur)** dhe **tekstile**.

Tabela 2 Numri i Bizneseve

Aktiviteti	Numri
Market	23
Auto-servise	12
Restorant	4
Fasoneri	1
Magazinë	4
Elektroshtëpiake	7
Mobileri	2
Materiale Ndërtimi	2
Gjithsej	55

Burimi: Bashkia Mat, Përpunoi CO-Plan 2022

Figura 19 Harta e Aktivitetve Gjeneruese



Burimi: CO-Plan, 2022

3.6.2 Mundësitë për rikuperimin/co-procesimin e mbetjeve

Bazuar në të dhënat e deklaruara për gjenerimin e mbetjeve në bashkinë Mat, përcaktimet ligjore të lidhura me sasine ditore të gjenerimit të mbetjeve sipas zonave si dhe ndarjen merkologjike të mbetjeve, del në pah një sasi e përafert e mbetjeve të cilat mund të përdoren për prodhimin e Lëndëve Djegëse Alternative.

Sasia e këtyre mbetjeve është në varësi të nivelit të riciklimit që realizohet ose planifikohet në territorin e bashkisë. Duke marrë në konsideratë që aktualisht nuk kryhet asnjë process riciklimi nga bashkia apo organe të tjera, përlogaritjet që rreth 2000 ton mbetje mund të përdoren në procesin e bashkë-përpunimit nga impiante të ndryshme termike që e zotërojnë lejet përkatëse dhe kapacitetet teknologjike të nevojshme.

Mbetjet që janë marrë në konsideratë për prodhimin e lëndëve djegëse alternative i përkasin kryesisht tipologjive si mbetje letre dhe kartoni, mbetje plastike, mbetje druri, mbetje tekstile dhe disa kategori të tjera mbetjesh të përziera.

Nga sa më lart evidentohet, në terma të përgjithshëm, mundësia e bashkisë Mat për të gjeneruar të ardhura nga mbetjet bashkiake, duke marrë parasysh këtu edhe reduktimin e sasisë së mbetjeve të depozituara në landfill, gjë e cila do të ulte kostot aktuale që shkojnë për këtë qëllim, sikundër edhe do të kontribuoj në gjenerimin e të ardhurave nga trejetimi LDA i cili në vitet e para duhet projektuar për të mbuluar kostot e investimit në teknologjinë e prodhimit të LDA e më pas të jetë i dedikuar për përmirësime në infrastrukture

3.7 KONKLUZIONE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË E MATIT

Për të ofruar shërbimin e plotë në të gjitha njësitë administrative është e nevojshme që Bashkia të rrisë numrin e stafit mbikëqyrës dhe operaconal për të rritur performancën e shërbimit.

Bashkia duhet të azhurnojë dhe miratojë Rregulloret e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të aplikojë praktikën e ndryshme të riciklimit dhe në përgjithësi për reduktimin e mbetjeve. Nga vlerësimi i përafërt i përbërjes së mbetjeve urbane dhe aktivitetit bujqësor që zhvillohet në territorin e kësaj bashkie, është shumë e përshtatshme krijimi i skemës së kompostimit të mbetjeve organike.

Situata e tarifave të pandara të aplikuara, duke zbatuar tarifat bllok për të gjitha shërbimet e ofruara nga Bashkia e Matit (pastrimi, gjelbërimi dhe ndriçimi). Njëkohësisht, shpërndarja e barrës fiskale e shpërndarë midis kategorive të biznesit dhe familjeve duhet rivlerësuar.

Megjithatë vlerësohet se shërbehet në 100% të popullsisë urbane dhe 45% rurale duhen analizuar mënyrat e shpërndarjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM) sidomos në zonat rurale ku vihet re se disa banesa ndodhen në distanca të largëta nga këto pika shërbimi duke vënë në diskutim ofrimin e shërbimit. Mundet të konsiderohet dhe shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në çdo fshat për disa zona rurale, rritja e numrit të PGM pasi mund të ofrohet shërbim më i mirë për këto zona.

Ndërhyrja në vend-depozitim është shumë urgjente. Së pari është e nevojshme të bëhet rehabilitimi i sipërfaqes dhe më pas që do të nevojitet ndërtimi i një stacioni të ri transferimi të mbetjeve me kushte të duhura teknike dhe sanitare

Bashkia Mat vlerëson si sfida deri në vitin 2025, përmirësimin e cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe zbatimin e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve. Ndërtimi i një vend-depozitimi përfundimtar është gjithashtu një objektivi afatshkurtër për Bashkinë e Matit.

IV. ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE

4.1 ANALIZA FINANCIARE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Bashkia Mat ka një popullsi prej rreth 27,857 banorë në bazë të regjistrimit të INSTAT (CENSUS i vitit 2011) dhe rreth 36,772 banorë bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile (janar 2021).

Mospërputhja midis dy shifrave është zbutur me 30% e diferencës midis dy shifrave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke sygjyeruar për rreth 30,532 banorë. Numri i popullsisë i llogaritur nga MFE është i rëndësishëm pasi është përfshirë në formulën për shpërndarjen e transferimit të pakushtëzuar. Zakonisht, bashkitë kanë tendencë të planifikojnë buxhetin dhe ofrimin e shërbimeve bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile për popullsinë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të bëhet e qartë dallimi mes tre vlerave të popullsisë.

Gjatë vitit të kaluar janë faturuar rreth 11,940 familje dhe 85% e tyre kanë paguar tarifën e menaxhimit të mbetjeve të paktën një herë. Për sa ju përket bizneseve, gjatë vitit të kaluar bashkia ka faturuar rreth 679

ndërmarrje dhe vetëm rreth 90% e tyre ka paguar tarifën e menaxhimit të mbetjeve të paktën një herë gjatë vitit të kaluar. Shkalla e arkëtimit për institucionet publike është 95%. Janë 11,940 familje dhe 679 biznese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin nën administrim të bashkisë Mat. Duke i kategorizuar sipas madhësisë, ka rreth 545 biznese të vogla dhe rreth 134 biznese të mëdha.

Bashkia e Matit zbaton tarifa të diferencuara për familjet sipas zonës së shërbimit ku banojnë sot dhe për ndërmarrjet në varësi të kategorisë së biznesit dhe madhësisë së aktivitetit. Për familjet, zbatohet një tarifë e përbërë duke përfshirë në të njëjtën tarifë: menaxhimin e mbetjeve, ndriçimin publik dhe tarifat e gjelbërimit. Ndërsa, për ndërmarrjet këto tre tarifa janë të ndara bazuar në klasifikime deri në 2019 të Paketa Fiskale. Për banorët e familjeve në qytetin e Burrelit, tarifa e shërbimeve arrin në vlerën 2,100 lekë në vit dhe për ata që banojnë në njësitë administrative/ zona rurale arrin në 750 lekë në vit.

Taksa e pastrimit dhe e menaxhimit të mbetjeve të aplikuara për biznesin e vogël rezultojnë të jetë shumë më i lartë krahasuar me atë të familjes, duke evidentuar një zhvendosje të qartë të barrës fiskale për këtë kategori. Për bizneset e vogla që ndodhen në zonën e qytetit, niveli minimal i tarifës së aplikuar është rreth 15,000 lekë në vit dhe niveli më i lartë është 20,000 lekë në vit bazuar në tipologjinë e biznesit dhe vendndodhjen (qyteti i Burrelit ose njësitë administrative). Ndërsa në rastin e ndërmarrjeve të mëdha, tarifa e menaxhimit të mbetjeve varion nga niveli minimal prej 70,000 lekë vit në një nivel maksimal prej 500,000 lekë në vit (aplikuar për ndërmarrjet e cilësuar VIP të veçanta/industria nxjerrëse).

Taksa e shërbimeve për familjet mbledhet përmes faturës së ndërmarrjes së Ujësjetës Kanalizimeve dhe pagesave në bashki. Bazuar mbi informacionin e siguruar nga Drejtoria e Ekonomike në Bashkinë Mat, të ardhurat nga tarifat e shërbimeve (pastrim, ndriçim, gjelberim) kanë qenë rreth 16.000.000 lekë gjatë vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve është rreth 21,225,526 lekë gjatë vitit të kaluar.

4.2 TARIFAT AKTUALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Mat, në çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin.

Pagesa për tarifën e menaxhimit të mbetjeve është detyrim vjetor.

4.2.1 Tarifat e menaxhimit të mbetjeve për kategorinë biznes

Paketa Fiskale 2019 ka të parashikuara nivelet e tarifës së menaxhimit të mbetjeve për bizneset të ndara sipas:

- Madhësisë së biznesit, xhiros vjetore.
- Kategorisë së aktivitetit.
- Vendndodhjes, duke ndarë në **Qytet** dhe **Njësi Administrative**

Përveç niveleve të përcaktuara sipas kategorive më sipër paketa fiskale bën diferencime për kategori të veçanta siç janë:

- Per kompanitë VIP me tarifë 500,000 lekë/vit.
- Për Biznesi vogël me tarifë pastrimi 20.000 lekë/vit.
- Për bizneset e madh tarifë pastrimi 70.000 lekë/vit.

Ndërkohë është përcaktuar edhe tarifa e depozitimit të mbetjeve inerte në nivelin 300 lekë/m³.

Për ndërtimet e reja është përcaktuar tarifë e veçantë pastrimi e cila paguhet në momentin e marrjes së lejës së ndërtimit:

Lloji i ndërtimit	Niveli i tarifës në lekë
Leje ndërtimi për banesë	2 500

Për sa i përket tarifave të menaxhimit të mbetjeve për bizneset në paketën fiskale janë parashikuar si më poshtë:

Tabela 3 Niveli i tarifës së pastrimit për kategoritë e bizneseve.

Nr	LLOJI I AKTIVITETIT	BV			BM	VIP
		Xhiro 0-2 ml	Xhiro 2 ml-5ml	Xhiro 5 ml-14ml		
		NIVELI I TARIFËS				
B.1	SHITJE ME PAKICË					
1	Mish	17,000	22,000	34,000	60,000	150,000
2	Peshk	22,000	27,000	32,000	60,000	150,000
3	Bylmet	17,000	22,000	27,000	60,000	150,000
4	Artikuj ushqimorë	17,000	24,000	32,000	70,000	150,000
5	Fruta-Perime	14,000	17,000	22,000	60,000	100,000
6	Veshje dhe artik uj te ndryshëm industrial	9,000	16,000	22,000	60,000	150,000
7	Bar, Kafe, Fast-Food, Byrektore e të ngjashme	14,000	22,000	27,000	60,000	150,000
8	Bar - Restorant	17,000	22,000	32,000	60,000	150,000
9	Produkte farmaceutike të ngjashme me to	22,000	30,000	37,000	75,000	200,000
10	Pub, Diskoteka etj të ngjashme	22,000	27,000	32,000	60,000	150,000
11	Tregti mobilie e të ngjashme me to	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
12	Materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike etj të ngjashme me to	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
13	Kancelari	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
14	Materiale të ndryshme, artikuj të ndryshëm	17,000	22,000	32,000	60,000	150,000
15	Kinkaleri, Parfumeri etj të ngjashëm	17,000	22,000	32,000	60,000	150,000
16	Materiale bujqësore dhe blegtorale e të ngjashme me to	14,000	22,000	32,000	60,000	130,000
17	Pjesë këmbimi për automjete, vaj, filtra etj të ngjashme	14,000	22,000	32,000	60,000	150,000
18	Tregti hidrokarburesh, gaz, naftë, benzinë, karburante të ndryshme	17,000	22,000	32,000	70,000	250,000
19	Tregti paisje elektroshtëpiake, elektronike etj të ngjashme	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
20	Tregti lëndësh drusore (dru zjarr, dërrasa) etj të ngjashme me to	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000

21	Tregti duhani dhe të ngjashme	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
22	Tregëti skrapit dhe materiale të tjera të ngjashme	22,000	32,000	52,000	80,000	200,000
23	Tregëtim grumbullim të bimëve medicinale e të ngjashme me to	17,000	22,000	32,000	60,000	150,000
24	Tregëti lëndë plasëse e të ngjashmë	17,000	22,000	32,000	80,000	200,000
25	Tregëti pemësh frutore dhe dekorative	12,000	17,000	32,000	60,000	150,000
B.2	TREGTI ME SHUMICË					
1	Magazina, dyqane, reparte prodhimi etj të cilat realizojnë shitje me shumicë, supermarkete, hipermarkete e të ngjashme	22,000	27,000	32,000	110,000	300,000
B.3	PRODHIM					
1	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	12,000	19,000	29,000	90,000	170,000
2	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	17,000	22,000	27,000	110,000	200,000
3	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash (pastiçeri), mishi, peshku, bylmeti, pijesh etj të ngjashme me to	20,000	27,000	32,000	90,000	170,000
4	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	17,000	22,000	27,000	90,000	150,000
5	Prodhim, përpunim vajrash, naftë, gazit e nënprodukt etj të ngjashme me to.	22,000	27,000	32,000	60,000	200,000
6	Implante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to	22,000	27,000	32,000	60,000	200,000
7	Përpunim mishi, peshku etj të ngjashme me to	17,000	22,000	32,000	60,000	150,000
8	Implante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera të ngjashme	17,000	22,000	27,000	60,000	150,000
9	Prodhim përpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to	20,000	27,000	32,000	60,000	200,000
10	Shtypshkronja etj të ngjashme me to.	17,000	22,000	27,000	60,000	150,000
11	Argjendari dhe përpunim metalesh të çmuara (ar, argjend etj ngjashme)	17,000	22,000	27,000	60,000	200,000
B.4	SHËRBIME					
1	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, punime tomerie, saldator, riparim biçikletash, manjetofon, pajisje elektronike, kompjutera, telefona, riparim orësh, pajisje fonie e të tjera të ngjashme me to	12,000	14,000	17,000	60,000	130,000
2	Autoservis, gomisteri, mekanik, oficinë për riparim makinash etj të ngjashme	14,000	17,000	27,000	60,000	150,000
3	Agjensi udhëtimi, agjensi imobiliare, agjensi doganore etj të ngjashme me to	10,000	12,000	17,000	60,000	150,000
4	Institucione financiare: agjensi transferim parash, banka e institucione të tjera të ngjashme	12,000	17,000	22,000	80,000	400,000
5	Shërbime fotokopjimi, sallon bukuri, Parukeri, Floktore, Berber, rrobaqepës kurse për makina (autoshkolla) për traktorë, për kompjuter e për parukeri, grafi dentare, konviktet, parkimi i makinave, lavazhe makinash, bilardo, lavaxterite, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme	12,000	17,000	22,000	60,000	100,000

	(gjimnastike, kalçeto, aerobie, cirçe, kënde lojrash për fëmije, ping pong, etj.) e të tjera sherbime të ngjashme me sherbimet e lartepmendura.					
6	Fotograf, Kameraman, Fotostudio, Foto montazh e të tjera të ngjashme	12,000	17,000	22,000	60,000	100,000
7	Supervizion, Kolaudim rrugësh, ndërtimesh të ndryshme	22,000	27,000	32,000	60,000	150,000
8	Shitje libri, biblioteka, shtëpi botuese	12,000	14,500	17,000	60,000	100,000
9	Lojra kompjuterike, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura, qendër interneti	12,000	17,000	22,000	60,000	100,000
10	Hoteleri, Motele, Shtëpi pritje për qëllime biznesi	12,000				
11	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet)	12,000				
12	Shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore(dentist,laborant,etj), shërbimet në laboratorë diagnostifikimi, analizash mjekësore etj të ngjashme	22,000	27,000	32,000	60,000	130,000
13	Punime me Fadromë, gjermime, ngarkim shkarkim etj të ngjashme	12,000	17,000	22,000	60,000	200,000
14	Studio: Ligjore, Kontabël, Projektim, Zbatim ndërtime civile e të përziera e të ngjashme	22,000				
15	Agjensi funerali	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
16	Dhoma frigoriferike për depozitim fruta – perime, etj të ngjashme	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
17	Media elektronike dhe e shkruar, Radio. Televizion, etj të ngjashme me to	12,000	17,000	22,000	60,000	150,000
B.5	PROFESIONE TË LIRA					
1	Avokatet, noter, mjek, mjeku-laborant, ekonomist kontabël të miratuar, eksperti kontabël të autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomet, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, përmbartues privat, elektrikist, e të tjera profesione te lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme , galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike, e të tjera të ngjashme me to që nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit me TVSH	9,000	12,000	17,000	60,000	150,000
B.6	AMBULANT					
1	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante private e të ngjashme me to	5,000				
B.7	TRANSPORT					
b.7.1	Transport pasagjerësh					
1	Autoveturë 4+1	2,000	5,000	8,000	15,000	30,000
2	Automjet 6-9 vende	3,000	6,000	20,000	40,000	50,000
3	Automjet 10 – 25 vende	4,000	7,000	20,000	40,000	50,000
4	Automjet 26 – 50 vende	5,000	8,000	20,000	40,000	50,000
b.7.2	Transport mallrash					
1	Automjet deri në 3.5 ton	2,000	5,000	8,000	15,000	30,000

2	Automjet 3.5 tonë deri më 10 ton	3,000	6,000	10,000	15,000	35,000
3	Automjet 10 tonë deri në 16 ton	3,000	7,000	20,000	35,000	50,000
4	Automjet mbi 16 ton	3,000	7,000	20,000	35,000	50,000
B.8	ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE (OJF)					
1	Organizata jofitimprurëse (ojf), shoqata e etj	12,000				
B.9	SUBJEKTE NDËRTIMI					
1	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to	22,000	32,000	42,000	80,000	150,000
2	Rikonstuksione të pjesëshme	12,000	22,000	32,000	80,000	140,000
3	Subjekte ndërtimore për institucione arsimore dhe kulturore	9,000	14,000	22,000	60,000	110,000
4	Subjekte për nxjerrje prodhim, përpunim guri, inertesh dhe të ngjashme me to	22,000	32,000	42,000	80,000	150,000
B.10	KOMPANI MINERALES					
1	Kërkim, shfrytëzim, Import – Eksport mineralesh të dobishëm e të ngjashëm	30,000	50,000	70,000	100,000	300,000
2	Prodhim, përpunim, mineralesh të domishme (galeri, fabrika, uzina) e të ngjashme me to	95,000	200,000	400,000	600,000	1,000,000
B.11	LOJRA FATI					
1	Lloto, Apex, Kazino, Baste sportive etj ngjashme me to	200,000				
B.12	NDËRMARRJEDHE ENTET SHTETËRORE					
1	Dega e Thesarit	50,000				
2	Njesia e Kujdesit Shendetesor Mat	80,000				
3	Agjensia e Sigurimet Shoqërore Mat	100,000				
4	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	45,000				
5	Komisariati i Policisë Mat	50,000				
6	Drejtoria e Buqësisë	50,000				
7	Zyra e Arsimit Mat	50,000				
8	Dega e Tatim Taksave Mat	50,000				
9	Nënprefektura Mat	50,000				
10	Kadastra Mat	50,000				
11	Instituti i Statistikave Dega Mat	20,000				
12	Zyra e regjistrimit të Pasurisë	80,000				
13	Drejtoria e Rezervave Mat	80,000				
14	Burgu Burrel	200,000				
15	Zyra Vendore e Punësimit Mat	50,000				
16	Ndërmarrja Gjeologjike Mat	50,000				
17	Ndërmarrja e Ujrave	50,000				
18	Prokuroria e Rrethit Gjygsor Mat	100,000				
19	Gjykata e Rrethit Mat	100,000				
20	Drejtoria e Spitalit Burrel	200,000				
21	ISHKSH	100,000				
22	Qendra shendetesore Burrel	80,000				
23	Qendra shendetesoren Komsit	40,000				
24	Qendra shendetesore Ulez	40,000				

25	Qendra shendetesore Lis		40,000			
26	Qendra shendetesore Baz		40,000			
27	Qendra shendetesoren Rukaj		40,000			
28	Qendra shendetesore Derjan		40,000			
29	Qendra shendetesore Macukull		40,000			
30	Policia Ushtarake		40,000			
31	Reparti Ushtarak		40,000			
32	Rekrutim Mobilizim		40,000			
33	Partitë Politike		5,000			
34	Të tjera		2,000			
B.13	NDËRMARRJET DHE INSTITUCIONET SHA					
1	Shoqëritë e Sigurimeve		50,000			
2	Ujësullësi		200,000			
3	Albtelecom sha		300,000			
4	Posta Shqipëtare		300,000			
	OST sh.a		300,000			
5	OSHEE sh.a,		300,000			
6	Hidrocentalet me kapacitet nga 0 deri ne 5 mega vat		500,000			
7	Hidrocentalet me kapacitet nga 5 deri në 10 mega vat		800,000			
8	Hidrocentalet me kapacitet mbi 10 mega vat		1,000,000			
B.14	Në të gjitha njësitë administrative (ish komunat)	50%	50%	50%	50%	100%

Burimi: *Bashkia Mat, 2021*

Niveli i tarifave është detyrim vjetor dhe llogaritet për vitin kalendarik.

Ngarkohet Drejtoria Ekonomike për faturimin dhe arketimin e Tarifave.

4.2.2 Tarifa e Menaxhimit të Mbetjeve Familjare

Tarifat për familje të parashikuara në paketën fiskale 2021 janë tarifa mikse ku përfshihen edhe shërbimet e gjelbërimit dhe ndriçimit. Tarifat paguhen nga çdo familje e regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile. Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik.

Tarifa e shërbimit arkëtohet nga Ujësullës-Kanalizime Mat ndërsa për rastet kur familja nuk ka kontratë me Ujësullës-Kanalizime, do të arkëtohet pranë Bashkisë Mat së bashku me taksat e tarifave të tjera për çdo familje.

Në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Mat Nr. 137, DATË 22.12.2020, "Për miratim të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021", përcaktohet në pikën B.4. emërtimi "Tarifa e Shërbimit Komunitar (Pastrim, Ndriçim dhe Gjelbërim)".

Aplikimi i kësaj tarife mikse, siç e përmendëm më sipër krijon probleme për eficiencën e tarifimit dhe nuk le mundësi të një ndarje të drejtë të tarifës. Pavarësisht këtij diskutimi tarifave të përcaktuara për familjet janë si më poshtë:

Niveli i tarifës për qytetin: 1,800 lekë/vit.

Niveli për Nj. A – zone rurale 900 lekë/vit

Në paketën fiskale ka të përcaktuar dhe kategoritë e familjeve të cilët janë të përjashtuara nga pagesa e tarifave sipas legjislacionit (veteranët, personat me invaliditet, etj).

Në paketën fiskale janë shtuar gjatë vitit 2021 edhe masa administrative (gjoba) për rastet si më poshtë:

Tabela 4 Tabela e gjobave për kundravajtjet administrative në mjedis

G	Gjobë për hedhje të materialeve inerte në vende të pamiratuara	lekë/m ³	3,000
1	Hedhja dhe grumbullimi i materialeve inerte ne vende të pa autorizuara apo miratuara	Lekë/rast	5,000 – 10,000
H	Gjobë për dëmtime dhe vjedhje të grumbullesëve të mbetjeve		
1	Për dëmtimin dhe prishjen e kazanëve të plehrave	lekë/copë	10,000 - 15,000
2	Për vjedhjen e kazanëve të plehrave	lekë/copë	15,000 - 20,000
3	Për dëmtimin dhe prishjen e koshave të mbetjeve	lekë/copë	2,000
4	Për vjedhjen e koshave të mbetjeve	lekë/copë	5,000
5	Për hedhjen e mbetjeve nga dritaret, ballkone	Lekë/rast	2,000

4.2.3 Konkluzione

Në Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Mat po punohet për vënien në funksionim të sistemit TAIS për menaxhimin e taksapaguesve dhe të bëhet e mundur faturimi nëpërmjet sistemit të automatizuar.

Taksa e shërbimeve për familjet mbledhet përmes faturës së Ndërmarrjes së Ujësjellës- Kanalizimeve. Bazuar mbi informacionin e siguruar nga Drejtoria e Ekonomike në Bashkinë Mat, dhe Drejtoria e Thesarit, të ardhurat nga tarifat e shërbimeve (pastrim, ndriçim gjelbërim) kanë qenë rreth 16 000 000 lekë gjatë vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve është rreth 21,225,526 lekë gjatë vitit të kaluar.

Sipas përlllogaritjeve rezulton se Bashkia Mat ka kapacitetete të mjaftueshme financiare për të bërë të mundur implementimin e një pjese të madhe të veprimeve konkrete të parashikuara në planin e veprimit (*shih kapitullin VI*).

4.3 TARIFIMI PROGRESIV SIPAS LIGJIT

4.3.1 Përqsja që sjell modeli

Ky model përfaqëson një qasje më gjithëpërfshirëse në menaxhimin e tarifave. Ajo përfshin më shumë tregues të gjenerimit të mbetjeve dhe hap mundësitë e krijimit të stimujve financiarë për praktikatat e mira. Megjithatë, duhet pasur parasysh se ky model ka nevojë për shumë të dhëna dhe përpunim të tyre.

Modeli është zhvilluar dhe konsoliduar në bazë të përvojës së modelit për menaxhimin e tarifave për furnizimin me ujë, duke përdorur faktorin e faturimit si kriter vendosje të tarifës (*Shih Tabela 4*) e cila në vetvete llogaritet nga një përzierje e disa treguesve.

Tarifa përcaktohet për tri kategoritë e gjeneruesve/klientëve, duke mos përcaktuar asnjë kriter paraprak shpërndarje të barrës së kostos. Në këtë rast, shpërndarja ndërmjet kategorive është e rregulluar vetë në bazë të multikritereve të vendosura për secilin grup klientësh.

Këto kritere, të përshkuara qartë më poshtë, janë:

- a) prania e oborrit;
- b) madhësia;
- c) largësia nga qendra e qytetit/njësisë administrative deri të gjeneruesi;
- d) masat për prodhuesit e mëdhenj apo të veçantë;
- e) masat reduktuese (nxitëse).

Në thelb, në këtë model, çdo gjenerues duhet të paguajë tarifën e referencës (faktori i faturimit = 1), e cila rritet në bazë të faktorëve të tjerë që shpjegohen më vonë në këtë kapitull.

Modeli ofron mundësinë për përjashtimin e familjeve nën skemën e ndihmës sociale. Siç shpjegohet dhe më sipër, përdorimi i këtij parametri zbritjeje është një vendim politik vendor, me ligj është Këshilli Lokal, i cili vendos për një përjashtim të plotë, gjysmëtarifor ose përfshirjen e këtij grupi në tarifa.

Modeli konsideron normën totale të mospagimit, por në përqindje të akumuluar, duke marrë parasysh shumën e parave të pambledhura nga viti i kaluar si një numër total/përqindje. Njësoj si më sipër, përqindja e mospagesës rrit tarifën për paguesit e rregullt. Vendimi për të rishpërndarë shpenzimet për paguesit e rregullt është një vendim politik. NJVV-ja mund të përdorë fonde të tjera për të mbuluar këtë hendek dhe për të shmangur shpenzimet shtesë, të padrejta për paguesit e rregullt.

Përdorimi i të gjithë treguesve dhe kritereve është shpjeguar më poshtë.

Modeli i respekton parimet kryesore tarifore në nivelin e mëposhtem:

Tabela 5 Parimet kryesore që respekton modeli tarifor

Parimet	+	
Ndotësi paguan	Llogaritje më e detajuar e tarifave e bazuar në disa tregues, e cila avancojnë kuptimin për nivelin e ndikimit të çdo gjeneruesi. Modeli mundëson stimulimin për menaxhimin me mençuri të mbetjeve, duke futur faktorin reduktim tarifor.	
Transparenca	Modeli siguron transparencë të plotë për përdoruesit, duke prodhuar një faturë të detajuar. Disa parametra përdoren për të dalluar çdo klient nga tjetri. Sistemi tarifor mund të përdoret për qëllime informative në faturë.	
Efiçienca menaxheriale	Mundëson një informacion të plotë për çdo klient.	Kërkon shumë të dhëna paraprake dhe një përditesim të shpeshtë të disa prej tyre. Sistemit duhet të përdoret vetëm nga profesionistë të trajnuar.

Burimi: Bashkia Mat 2021

Tabela 6 Përcaktimi i kategorive dhe parametrave që do të influencojnë tarifën për çdo klient (=“malus”)

Faktorët e përlogaritjes së tarifës													
Kategoria		Oborr		Madhësia			Distanca nga qendra			Prodhues “i madh” apo i vogël		Masat reduktuese (incentiva) (përdoret në rastet e aprovuara, që kualifikohen për këtë masë)	
		Jo	Po	E vogël	E mesme	E madhe	0-5 km	5-10 km	>10 km				
				1—3 pers.	4-6 pers.	>6 pers.							
Familje		0%	100%	0%	40%	80%	0%	20%	40%	0%	100%	0%	-20%
						> 30							
				15-Jan	16-30	punonj, për çdo punonj. shtesë.							
				punonj.	punonj.								
Institucion		20%	100%	20%	60%	2.70%	20%	40%	60%	20%	100%	0%	-20%
				Sip. e biznesit: 0-50 m ²	Sip. e biznesit: 50-100m ²	> 100 m ² , për çdo 50m ² shtesë							
Biznese kat. 1	Prodh. i ulët	20%	100%	20%	40%	20%	20%	40%	60%	20%	100%	0%	-20%
Biznese kat. 2	Prodh. i mesëm	20%	100%	40%	60%	20%	20%	40%	60%	20%	100%	0%	-20%
Biznese kat. 3	Prodh. i lartë	20%	100%	60%	80%	20%	20%	40%	60%	20%	100%	0%	-20%

Burimi: Bashkia Mat; 2021

Tabela 7 Përlllogaritja e faktorit të madhësisë

Kategoria	Madhësia			Komente
	<i>E vogël</i>	<i>E mesme</i>	<i>E madhe</i>	
	<i>1—3 pers.</i>	<i>4-6 pers.</i>	<i>>6 pers.</i>	Mbetet në varësi të Bashkisë nëse do të aplikohet faktori i tarifimit dhe nqs po, deri ne çfarë mase. Kjo fazë përcaktohet në fazën e dytë të planit të veprimit.
Familje	0%	+ 40%	+ 80%	Mbetet në varësi të Bashkisë nëse do të aplikohet faktori i tarifimit dhe nqs po, deri ne çfarë mase. Kjo fazë përcaktohet në fazën e dytë të planit të veprimit.
	15	30	<i>> 30 punon. për çdo punonj. shtese</i>	Sipas studimeve të ADEME (Francë), sasia e mbetjeve të gjeneruara nga një punonjës përfaqëson 20% të mbetjeve të gjeneruara nga një person në familje. = > 5 punonjës = 1 një person në familje.
Institucion	+ 20%	+ 60%	+ 2.7%	Për “e vogël” në “të mesme” = +40% për 15 persona = +2.7% për person
	50	100	<i>> 100 m², për çdo 50 m² shtesë</i>	
Biznese kat. 1	+ 20%	+ 40%	+ 20%	Kategoria 1, përfshin kategoritë: shërbime, profesione të lira dhe ambulante ² .
Biznese kat. 2	+ 40%	+ 60%	+ 20%	Kategoria 2, përfshin kategoritë: shitje me pakicë, shitje me shumicë dhe transport.
Biznese kat. 3	+ 60%	+ 80%	+ 20%	Kategoria 3, përfshin kategorinë: prodhim.

Burimi: Bshkia Mat, 2021

4.3.2 Shpjegimi i faktorëve

Faktori oborr

Ky faktor vjen nga vëzhgimi që është bërë në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të mëdha (p.sh. Shkodrës), ku një pjesë e rëndësishme e mbetjeve është vegjetale dhe vijnë nga kopshtet individuale. Eliminimi i këtyre mbetjeve vegjetale, që shpesh janë shumë voluminoze, kushton shumë për Njësinë. Kjo kosto shtesë duhet të mbështetet nga pronarët e këtyre oborreve. Kjo është arsyeja pse modeli propozon dyfishim të faktorit reference (+100%) për gjeneruesit të cilët kanë një oborr. Përdorimi i këtij faktori ofron një qasje progresive për të krijuar një komunikim me komunitetin, e cila e kombinuar me “faktorin e nxitjes” (aplikimit të masave ligjore për zvogëlimin e tarifës), ofron një nxitje për kompostimin dhe zgjidhje të tjera.

Lidhur me këtë faktor, Njësia e Vetëqeverisjes Vendore duhet të konsiderojë si më poshtë:

- Cila është përqindja e mbetjeve vegjetale që vijnë nga kopshtet?
- Sa ndikon kjo në koston e shërbimit (grumbullimit, transportit dhe të trajtimit)?

Modeli i propozon shkallën e ndikimit si më poshtë të faktorit oborr për llogaritjen e tarifave, por proporcionet mund të përshtaten nga vetë Njësia:

Tabela 8 Tabela e faktorizimit për oborret

Kategoria	Oborri	
	Jo Po	
Familje	0%	+100%
	--	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh
Institucion	+20%	+100%
	Masë mbështetëse	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh
Biznes	+20%	+100%
	Masë mbështetëse	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh

Burimi: Bashkia Mat; 2021

Një vlerë baze prej +20% aplikohet mbi tarifën për bizneset dhe institucionet, për të mbështetur uljen e barrës për popullatën.

Faktori madhësi

Ky faktor supozon se sasia e mbetjeve të gjeneruara ndikohet nga “madhësia” e prodhuesit. Faktori i madhësisë përllogaritet në mënyrë të ndryshme për çdo kategori gjeneruesish.

Familjet

Gjenerimi i mbetjeve është në proporcion me numrin e njerëzve që jetojnë në familje ku janë propozuar 3 kategori.

Tabela 9 Modeli propozon ndikimin e faktorit madhësi në llogaritjen e tarifës

Kategoria	Madhësia		
Familje	E vogël	E mesme	E madhe
	1-3 pers	4-6 pers	>pers
	0%	+40%	+80%

Burimi: Bashkia Mat; 2021

Koeficientët mund të përshtaten nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, sipas kushteve dhe politikave vendore.

Institucionet

Kategoritë janë përcaktuar në bazë të numrit të të punësuarve, në bazë të kriterëve të përcaktuara për familjet (5 punonjës janë konsideruar si 1 person i një familje). Këto kategori mund të ndryshohen në perputhje me njohuritë lokale të institucioneve.

Ndërsa për faktorët e tjerë, një bazë minimale prej 20% është aplikuar në llogaritjen e tarifave për të gjitha institucionet. Për një numër të mesëm punonjësish, aplikohet një shtesë prej 40% dhe për më tej një vlerë prej 2,7% aplikohet për çdo punonjës shtesë kur institucioni është më shumë se 30 punonjës.

Tabela 10 Mënyra si bëhet përllogaritja e kriterit të madhësisë për familje në Excel

Kategoria	Madhësia		
Institucione	E vogël	E mesme	E madhe
	1—15 pers.	16-30	> 30 puno. për çdo punonj. shtesë
	+ 20%	+ 60%	+ 2.7%

Burimi: Bashkia Mat; 2021

Një tavan prej +900% është vendosur (rregullohet me anë të formulës), në mënyrë që të ndalohet rritja e mëtejshme e këtij faktori kur ai syon në një faktor të faturimit më të lartë se dhjetë herë faktorin referencë të faturimit. Kjo do të thotë se mbi 345 të punësuar, ky faktor nuk do të rritet më. Mundësia e kufizimit të këtij faktori është në varësi të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore për ta përdorur.

Bizneset

Për përcaktimin e faktorit të madhësisë, në bazë të përvojës me këtë kategori gjeneruesish, është bërë ndarja e tyre në 3 kategori, mbështetur në grupimet që bëhen nga ligji për taksat vendore.

- **Kategoria 1** Gjeneruesi në shkallë të vogël të mbetjeve, ku hyjnë: shërbimet, profesionet e lira dhe ambulancat.
- **Kategoria 2** Gjeneruesi në shkallë të mesme të mbetjeve, ku hyjnë: dyqane me pakicë, dyqanet me shumicë dhe transporti.
- **Kategoria 3** Gjeneruesit në shkallë të lartë të mbetjeve, ku hyjnë: prodhimi.

Këtu koeficienti është i bazuar në sipërfaqen e ndërtesës (vetëm truall) të përdorur nga biznesi. Njësia bazë minimale është 50 m², e cila mund të ndryshohet në përputhje me njohuritë lokale.

Për faktorët e tjerë: një bazë prej 20% aplikohet në llogaritjen e tarifave për të gjitha bizneset;

+40% për kategorinë e dytë dhe 60% për kategorinë e tretë. Pastaj, koeficienti është në rritje 20% për çdo 50 m² shtesë.

Tabela 11 Mënyra si bëhet përllogaritja e kriterit të madhësisë për biznese në Excel

Kategoria	Madhësia			
		E vogël	E mesme	E madhe
Sip e biznesit		0-50 m ²	50-100m ²	>100m ² , për çdo 50m ² shtesë
Biznese kat.1	prodh i ulët	+20%	+40%	+20%
Biznese kat.2	prodh i mesëm	+40%	+60%	+20%
Biznese kat.3	prodh i lartë	+60%	+80%	+20%

Burimi: Bashkia Mat; 2021

Një tavan prej +900% është përcaktuar, në mënyrë që të ndalohet rritja e mëtejshme e këtij faktori kur con në një faktor të faturimit më të lartë sa dhjetë herë faktori referencë i faturimit. Kjo do të thotë se mbi 2.250 m², ky faktor nuk do të rritet më. Mundësia e kufizimit të këtij faktori është në dorë të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore për ta përdorur.

Faktori distancë

Ndërtimet e shpërndara kudo janë një burim i shpenzimeve të larta për shërbimet publike, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve. Ideja e këtij faktori në distancë është që të reflektojnë koston shtesë për komunitetin për mbledhjen dhe transportin në distancë “te largët”. Megjithatë, distanca nuk ka të bëjë me gjenerimin e mbetjeve dhe prodhuesi nuk ka asnjë ndikim mbi të. Kjo është arsyeja pse koeficientet e propozuar nuk janë shumë të lartë (20% për çdo hap).

Lidhur me përdorimin e këtij faktori, Njësia e Vetëqeverisjes Vendore duhet të marrë në konsideratë si në vijim:

- Kategoritë dhe koeficienti duhet të përshtaten me cilësitë e veçanta të NJA-së (shpërndarjen, nivelin ekonomik, kapacitetet teknike, etj.).

- Cila është politika e NJA-së në lidhje me menaxhimin e territorit? A ka një vullnet për përqëndrimin e ndërtimeve? Nëse po, koeficienti mund të jetë më i lartë që të nxisë këtë politikë.
- Sa e ndikojnë gjeneruesit e mbetjeve në distancë të largët koston e shërbimit (grumbullimin, transportimin dhe trajtimin)?
- Të merret në konsideratë se disa klientë me të ardhura të ulëta mund të gjenden larg për shkak të disa arsyeve, duke përfshirë edhe ato ekonomike (fshatrat e largëta).
- Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar klientëve që janë jashtë zonës së shërbimit ose të keqshërbyer (reduktim tarifor apo përjashtim).

Prodhues “i madh” ose “i veçantë”

Ky faktor është më i rëndësishëm për bizneset dhe institucionet sesa familjet. Ai është futur për të kompensuar situatën ku prodhuesi nuk ka kopësht, ka marrë me qira një ndërtesë të vogël me pak të punësuar në qendër të qytetit, por prodhon sasi të madhe të mbetjeve, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tij. Në këtë rast, nëse do të bazohet vetëm në faktorët, kopësht madhësi dhe distancë, ky gjenerues do të paguante tarifë shumë të ulët. Ky faktor i jep mundësinë NJA-së që të rregullojë shkallën e tarifës, në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet shkallës së ndikimit të këtij biznesi në menaxhimin e mbetjeve.

Si një vendim teknik dhe politik, NJA-të duhet të marrin në konsideratë si në vijim:

- Vendimi për të përcaktuar si një gjenerues i madh një biznes i takon NJA-së të bazohet në vlerësimin teknik të bërë nga administrata. Ky është, gjithashtu, një instrument për nxitjen e praktikave të mira.
- Krahasuar me bizneset e tjera apo institucionet të së njëjtës gamë gjenerimi (në lidhje me madhësinë), sa më shumë mbetje këta gjenerojnë? 2, 5, 10 herë më shumë? Kjo mund të jetë një bazë për të zgjedhur koeficientin e duhur.

Faktori për masat zbutëse (incentivat)

Ky faktor jep mundësinë për të ulur tarifën e gjeneruesit, i cili aplikon masa ligjore dhe të miratuara nga NJV-ja në reduktimin e sasisë së mbetjeve. NJVV-ja mund të propozojë një listë të masave që duhet të zbatohen për të përfituar nga ky faktor, si për shembull:

- Të ndajë letrën/ambalazhin dhe PET/plastikën dhe t'i nxjerrë këto rryma mbetjesh në rrugë vetëm në ditët e përcaktuara nga NJV-ja (në rast se njëësia e aplikon këtë strategji).
- Të bëjë kompostim mbetjesh.
- Të përdorë zgjidhje të veçanta dhe private.

Marrja e informacionit mund të jetë e komplikuar dhe të marrë shumë kohë. Ky faktor mund të konsiderohet i vështirë për t'u përdorur dhe për më tepër për t'u faktuar. Një mënyrë do të ishte që vetë klienti të faktojë punën që bën dhe arsyen pse e meriton të përfitojë nga kjo zbritje.

Lidhur me këtë faktor, NJV-ja duhet të konsiderojë si vijon:

- Cfarë lloj masash dëshiron të mbështesë NJV-ja?
- Cili është ndikimi i kësaj mase? Sa reflektohet ajo në kosto (uljen e saj)

Atribuimi i nivelit të tarifës për çdo klient - përcaktimi i faktorit të faturimit (*shembull*). Nën secilën kategori, listoni klientët (duke përdorur të dhënat e mbledhura nga burimet e përmendura më lart). Për secilin nga klientët, vlerat e parametrave duhet të përcaktohen një e nga një, në mënyrë që të llogaritet faktori i faturimit në fund të tabelës. Për familjet në ndihmë sociale, nëse zgjidhni "po", faktori i faturimit do të bëhet = 0.

Tabela 12 Përcaktimi i faktorëve të faturimit për secilin klient

Lista e klientëve	Oborri	Faktori	Madhësia	Faktori	Distanca	Faktori	Prodhues i madh	Faktori	Masa reduktuese	Faktori	Përfshirja për arsye sociale	Faktori totali faturimit
	Po/Jo	[-]	[banor], [punonj.] ose [m ² prone]	[-]	[km]	[-]	Po/Jo	[-]	Po/Jo	[-]	Po/Jo	[-]
Familjet												
(kryefamiljari/ja)												
Z. xyz	po	100%	7	80%	2	0%	jo	0%	jo	0%	po	0
Znj. stu	po	100%	5	40%	3	0%	jo	0%	po	-20%	jo	2.2
Institucionet												
Institucion I1	po	100%	31	63%	1	20%	jo	20%	po	-20%	jo	2.8
Institucion I2	jo	20%	345	900%	4	20%	jo	20%	po	0%	jo	10.6
Biznese kategoria 1												
Biznes B1.1	jo	20%	2250	900%	5	20%	jo	20%	po	-20%	jo	10.4
Biznes B1.2	jo	20%	60	40%	12	60%	po	100%	po	-20%	jo	3
Biznese kategoria 2												
Biznes B2.1	jo	20%	1000	400%	5	20%	jo	20%	po	-20%	jo	5.4
Biznes B2.2	jo	20%	30	40%	12	60%	po	100%	jo	0%	jo	3.2
Biznese kategoria 3												
Biznes B3.1	jo	20%	350	140%	5	20%	jo	20%	jo	0%	jo	3
Biznes B3.2	jo	20%	100	80%	12	60%	po	100%	jo	0%	jo	3.6
Total												46.4

Burimi: Bashkia Mat; 2019

4.3.3 Përlllogaritja e tarifës

Më poshtë jepet shembulli i përlllogaritjes së tarifës për çdo klient.

Tabela 13 Përlllogaritja e tarifës për çdo klient (shembull).

Klientë	Faktori i faturimit	Fatura	
Familje			
Z.	0	-	lekë/faturë
Znj	2.2	338	lekë/faturë
Institucione			
Institucion	2.8	435	lekë/faturë
Institucion	10.6	1,631	lekë/faturë
Biznese nën kategorinë 1			
Biznes B1.1	10.4	16,000	lekë/faturë
Biznes B1.2	3	4,620	lekë/faturë
Biznese nën kategorinë 1			
Biznes B2.1	5.4	8,310	lekë/faturë
Biznes B2.2	3.2	4,920	lekë/faturë
Biznese nën kategorinë 1			
Biznes B3.1	3	4,620	lekë/faturë
Biznes B3.2	3.6	5,540	lekë/faturë
Shuma totale e faturimit për 1	46.4	71,430	lekë/periudhë
periudhë (6 muaj)			
Shuma totale e faturimit për një vit		142,850.71	lekë/vit
Të ardhura (nëse shuma e mospagimit = shumë e përlllogaritur):		100,000	lekë/vit

Burimi: Bashkia Mat, 2020

Kjo mënyrë e llogaritjes së tarifës ka edhe disa disavantazhe të cilat duhet të vlerësohen përpara aplikimit të saj:

- Të dhënat që duhet të mblidhen janë të shumta dhe duan një periudhë përgatitore dhe angazhim të burimeve njerëzore. Megjithatë mbledhja e këtyre të dhënave do i shërbejë Bashkisë edhe për shumë aspekte të tjera.
- Të dhënat e hedhura në sistem do të kërkojnë burime njerëzore për t'i riazhonuar në mënyrë periodike.
- Përpunimi i të dhënave dhe faturimi për çdo klient më pas kërkon një softëare të posaçëm pasi është e vështirë nxjerrja e detyrimit tatimor për çdo klient nga formati excel.

Pavarësisht vështirësive që ka, Bashkia mund të selektojë vetëm disa nga kriteret që kërkon të faktorizojë dhe të aplikojë vetëm ato kritere.

Ky sistem për nga eficienta, transparenca dhe në respekt të parimit “ndotësi paguan” ngelet sistemi optimal.

4.4 KOSTIFIKIMI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

4.4.1 Metodologjia mbi kostifikimin e shërbimit

Kostifikimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve mbart në vetvete një sërë problematikash që lidhen si me vetë kompleksitetin e shërbimit (fazat nëpër të cilat kalon) ashtu dhe me bazën e të dhënave për t'u përdorur.

Si metodologji bazë për llogaritjen e kostos është marrë VKM-ja, Nr. 319, datë 31.5.2018, "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Si referencë është marrë manuali i DLDP-së Udhëzues, "Metodat e Llogaritjes së Kostos dhe Tarifës në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Nivel Njësie të Qeverisjes Vendore në Shqipëri", Tiranë 2013. Në të dyja materialet parimet janë të njëjta.

Në këtë raport, kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane do të trajtohet në nivel të ndarë fazash nëpër të cilat kalon procesi (mirëmbajtje, personel, zbrastje, grumbullim, transport, depozitim, amortizim, administrim), për çdo njësi zone shërbimi (Zona 1, qytet, Zona 2 rurale), për një ton mbetje të gjeneruar dhe për banor ose për *capita* të cilit i ofrohet shërbimi (popullata e shërbyer). Në terma të përgjithshëm, në kostifikimin e shërbimit në të tre variantet e konsideruar do të ndjekim një përfaqje (metodologji) të tipit *Activity Based Costing* (kostifikim sipas aktiviteteve të kryera). Përparësitë e kësaj metode kostifikimi qëndrojnë në faktin se kostot alokohen nëpër aktivitetet e identifikuara sipas një llogjike përkatësie të tyre.

4.4.2 Problematika

Në lidhje me të dhënat e vendosura në tabelën e llogaritjes së kostove ka nevojë për disa sqarime mbi burimin e tyre. Kryesisht të dhënat kanë qenë të vështira për t'u mbledhur, si pasojë e mungesës së statistikave të sakta, mospeshimit të mbetjeve, etj. Për këtë arsye një pjesë e të dhënave të vendosura janë bërë nga normat kombëtare të përcaktuara në VKM-në Nr.175, datë 19.1.2011, "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve" si dhe në draft strategjinë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Për të evituar këto mospërputhje si nivel ditor i gjenerimit të mbetjeve urbane do të konsiderohen normat teorike të propozuara nga Manuali për "Planifikimin e Menaxhimit Lokal të Mbetjeve" (DLDP, 2012). Njëkohësisht një pjesë e të dhënave janë nxjerrë nga praktika e përditshme e punës që kryhet në Bashki për menaxhimin e mbetjeve.

Tabela 14 Normat e gjenerimit të mbetjeve, Bashkia Mat

Norma	Qyteti Burrel	Njësitë administrative rurale
Norma e gjenerimit të mbetjeve_individ (kg/ditë)	0.6	0.4
Norma e gjenerimit të mbetjeve_biznes i vogël (kg/ditë)		6
Norma e gjenerimit të mbetjeve_biznes i mesëm (kg/ditë)		8
Norma e gjenerimit të mbetjeve_biznes i madh (kg/ditë)		1 5
Norma e gjenerimit të mbetjeve_institucione (kg/ditë)		6

Burimi: Bashkia Mat, 2020

Në kostifikimin e mbetjeve, krahas normës së gjenerimit të mbetjeve urbane të ngurta (nga bizneset dhe nga individët), luan rol të rëndësishëm numri i popullsisë së konsideruar për secilën nga zonat e shërbimit. Në çdo bashki ka 3 të dhëna mbi numrin e popullsisë:

1. Numri i popullsisë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile.
2. Numri i popullsisë sipas Census 2014 (Census 2014 i referohet të dhënave të popullsisë të rezultuara nga Census 2011 të përditësuara me normën e rritjes së popullsisë deri në vitin 2014).
3. Nisur nga diferencat në këto dy të dhëna, grupi i punës vlerësoi të përshtatshme përdorimin e një shifre më të zbutur në përputhje me atë të përdorur nga Ministria e Financave në Formulën e re për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar. Kjo vlerë bën një zbutje midis 2 vlerave të mësipërme duke qenë disi më afër realitetit.

Në [Shtojca3](#) janë paraqitur grafikët e mbulimit me shërbim të popullsisë bazuar në të dhënat e numrit të popullsisë të llogaritura nga MF, CENSUSI dhe RGJC. Duke u bazuar në formulën e MF, numri i popullsisë për Bashkinë Mat është **30,532** dhe vetëm **20,789** banorë marrin shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Tabela 15 Tabela e numrit të popullsisë, Bashkia Mat

	Qyteti Burrel	Nj. A. Rurale	TOTAL
Popullsia Census 2011->Adj Cencus 2014	10,963	16,894	27,857
Popullsia RGJC (2014)	16,361	20,547	36,908
Popullsia MF (formula)	12,602	17,930	30,532

Burimi: INSTAT, Bashkia Mat 2020

Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton sasia e mbetjeve të gjeneruara si më poshtë:


Tabela 16 Tabela e gjenerimit të mbetjeve, Bashkia Mat

Zonat	Qyteti Burrel	Nj. A. Rurale	Total
Mbetje urbane (ton/ditë)	8.82	3.3	12.0962
Mbetje urbane (ton/javë)	61.74	23.1	700
Mbetje urbane (ton/vit)	3,219	1.204	4,423

Burimi: Bashkia Mat 2020

Për Bashkinë Mat janë deklaruar një vlerë totale prej **4,423** ton mbetje në vit. Në këtë diferencë të kosiderueshme argumentohet me faktin se numri i popullsisë e cila realisht jeton në Bashkinë Mat është më i vogël se edhe vlera e marrë nga Ministria e Financave. Ky fakt përforcohet nga të dhënat e pasqyruara më poshtë duke parë se Bashkia Mat nuk ofron shërbim 100% në gjithë territorin e saj dhe nga llogaritja e sasive të mbetjeve të gjeneruara rezulton se është e nevojshme të ketë një numër më të madh të kontenierëve 1.1 m³, të cilët përdoren sot. Nga vëzhgimi dhe puna e përditshme rezulton se sasia e kontenierëve që janë në funksionim nuk janë të nevojshëm për grumbullimin e të gjithë sasisë së mbetjeve që gjenerohet. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet saisa aktuale e kontenierëve të shpërndarë dhe sasia që propozohet për të shpërndarë prej 45 kontenierësh 1.1m³, me qëllim mbulimin me shërbim në të gjithë territorin e bashkisë.

Figura 20 Numri i kontenierëve të nevojshëm në Bashkinë Mat



Burimi: CO-Plan, 2022


4.4.3 Rezultatet

Nga llogaritjet rezulton se shërbimi i grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve në total, kërkon një vlerë prej **23,423,803** lekë/vit.

Nga analizimi i grafikëve të rezultateve të kompostimit rezultojnë konkluzionet si më poshtë:

Kostoja e menaxhimit të mbetjeve sipas zonave është në raportin 66% për Zonën 2 (rurale) dhe 34% për Zonën 1 (qytet). Ky raport pasqyron të njëjtin raport të gjenerimit të mbetjeve në secilën zonë.

Figura 21 Raporti i Kostos së Menaxhimit të Mbetjeve



Burimi: Bashkia Mat, Përpunoi: CO-Plan 2022

4.5 SKEMAT E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Skenari 0- Skenari aktual i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Mat

Duke parë situatën ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Mat, si dhe duke u bazuar në disa studime dhe vëzhgime të bëra si nga ekspertë të jashtëm dhe nga puna e përditshme e specialistëve të Bashkisë në menaxhimin e mbetjeve, propozojmë disa skenarë të mundshëm për të menaxhuar mbetjet urbane.

Gjithsesi skenari aktual për menaxhimin e tyre është si më poshtë:

Skema aktuale e menaxhimit menaxhohet nëpërmjet 231 kontenerë 1.1 m³ (102 njesia qytet + 129 në 5 Nj.A. rurale) dhe prej 70 km linear itinerare. Në Bashkinë Mat ekziston 1 venddepozitim aktiv për të cilin gjatë përshkrimit të skenarëve do të kërkohet rehabilitimi i tij. Në zonën e shërbimit nuk ka pika grumbullimi të mbetjeve statike, të hapura.

Kosto Skenari 0

Sa i përket kostifikimit të skenarit, kostoja aktuale e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Mat është 23,423,803 lekë/vit, ndërsa kostoja për ton mbetje është 1.423 lekë/ton/vit si dhe kostoja për banorë është 635 lekë/banor/vit.

Skenari 0/A – Skenari i rikuperimit të mbetjeve / Prodhimi i lendeve djegëse alternative

Studimi Tregut i hartuar në kuadër të projektit “Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor”, vlerëson paraprakisht potencialin që Bashkia Mat ka për prodhimin e Lëndëve Djegëse Alternative, nisur nga sasi të totale të mbetjeve të gjeneruara dhe raportuara në Bashki dhe në studime të mëparshme mercologjike që janë kryer për këtë zonë:

Sasia totale mbetjeve të ngurta bashkiake:	4,483 ton/vit
Sasia e mundshme e LDA (RDF+SRF):	2,000 ton/vit
Fuqia kalorifike e përafërt:	55 GJ/vit
Potenciali ekonomik:	48,000 \$/vit

Këto të dhëna bazohen në skenarin bazik, ku aktualisht nuk kryhet asnjë nga praktikat e trajtimit sipas hierarkisë së mbetjeve por e gjithë sasia dërgohet për depozitim në Landfill.

Nga të dhënat evidentohet që, bazuar në vlerën e tregut për lëndët djegëse alternative, bashkia Mat ka një kapacitet prej rreth 48,000 \$/vit të dala nga mbetjet dhe që aktualisht nuk kanë asnjë vlerë, por përkundrazi kanë kosto për depozitim dhe tyre duke përfshirë transportin, stafin e angazhuar, efektet mjedisore etj.

Kosto Skenari 0-A


Studimi i Fizibilitetit që po hartohet në kuadër të projektit “Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor” ka angazhuar ekspertë të fushës të cilët do të parashtrojnë problematikat dhe do të prodhojnë skenarë të mundshëm për metodologjinë që mund të përdoret për prodhimin e Lëndëve Djegëse Alternative.

Pjesë të studimit do të jenë dhe analiza kosto-përfitim dhe referencat e përgjithshme ekonomike të lidhura me implementimin e një stacioni transferimi apo impianti për prodhimin e këtyre lëndëve. Kjo do të evidentojë dhe nivelin e përfshirjes së bashkisë Mat dhe një ide më të qartë të kostove të nevojshme për prodhimin e LDA.

Skenari 1- Përmirësimi i mbulimit dhe eficientimi i shërbimit të pastrimit të mbetjeve si dhe rehabilitimi i venddepozitimeve aktuale dhe ndërtimi i pikave të transferimit të mbetjeve dhe i skemave të kompostimit në Bashkinë Mat.

Në këtë variant përdoret skema aktuale e menaxhimit të mbetjeve duke e përmirësuar më tej atë. Gjithashtu ky skenar do të shërbejë dhe si skenar bazë për përshkrimin dhe analizimin e skenarëve të tjerë. Në këtë skenar mendohet të vazhdojë grumbullimi i padiferencuar në burim i mbetjeve të ngurta urbane nga bashkia Mat, nëpërmjet 231 kontenierëve me kapacitet 1.1 m³, të cilët grumbullohen 1 herë në ditë në zonën urbane dhe çdo 3 ditë në zonën rurale me 6 automjete (2 makina teknologjike 3.5-5 ton + 1 makinevetëshkarkues për mbetjet inerte së bashku me 3 mjete teknologjike 3.5 ton për Njësitë Administrative rurale). Sa i përket përmirësimit me anë të eficientimit të mbulimit me shërbimin e pastrimit të mbetjeve ka patur investime në blerjen e 28 kontenierëve të rinj 1.1m³, shtimin e 14.4 km itinerar për shërbimin e pastrimit të mbetjeve si dhe duke parashikuar rehabilitimin e fushës ekzistuese të mbetjeve e cila paraqet probleme të mëdha mjedisore. Duke u bazuar edhe në legjislacionin aktual (kryesisht Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 45, pika 3), depozitimi përfundimtar i mbetjeve duhet të bëhet në nivel rajonal dhe në këtë kuptim kjo skemë duhet me patjetër të parashikojë këtë dispozitë. Gjithashtu ndërtimin e pikës së re të transferimit të mbetjeve e cila do të jetë edhe pikë për diferencimin dhe selektimin e mbetjeve të riciklueshme.

Figura 22 Skema e Menaxhimit të Mbetjeve



Burimi: Bashkia Mat; 2020

Për të arritur këtë qëllim duhet të ndërmerren disa veprime dhe parashikohen disa investime dhe kosto të cilat kryesisht do të konsistojnë në;

- I. Largimi/trajtimi i sasisë së mbetjeve të depozituara tashmë në vend-depozitim aktual.
- II. Mbyllja dhe rehabilitimi i vend-depozitimit aktual, duke respektuar të gjitha kushtet dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit.
- III. Ngritja dhe vënia në funksionim i një stacioni transferimi për mbetjet. Ky stacion transferimi do të shërbejë për depozitimin e përkohshëm dhe të përditshëm të mbetjeve të Bashkisë Mat deri në momentin kur me mjete të përshtatshme me kapacitet të madh do të bëhet transporti prej stacionit të transferimit deri në landfillin rajonal. Për ndërtimin dhe funksionimin e stacionit të transferimit duhet të merren parasysh dhe të nxirret kostoja e veprimeve/investimeve të mëposhtme:

- IV. Sipërfaqja e tokës ku do të ngrihet dhe funksionojë stacioni i transferimit. Duhet pasur parasysh aspektet mjedisore në lidhje me ndikimin që do ketë funksionimi i këtij stacioni në mjedis. Gjithashtu duhet parë efektiviteti për përzgjedhjen e vendndodhjes duke marrë parasysh distancën nga PGM-të dhe nga lanfilli/incineratori rajonal.
- V. Në këtë skenar duhet të konsiderohet dhe fakti nëse ky stacion transferimi do të shërbejë dhe si pikë për ndarjen dhe selektimin e mbetjeve në mënyrë që të ulët sasia e mbetjeve të cilat do të çohen në lanfillin/incineratorin rajonal. Realizimi i një procesi të tillë në stacionin e transferimit nga njëra anë do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të cilat do çohen në lanfill/incinerator duke ulur ndjeshëm kostot e transportit për në stacionin e transferimit-landfillit rajonal dhe koston e trajtimit të mbetjeve në lanfillin rajonal, por nga ana tjetër kërkon një analizë të detajuar mbi efikasitetin e kostove të investimit dhe operimit për ndarjen e mbetjeve në këtë stacion transferimi.
- VI. Në përfundim të trajtimit të mbetjeve skenari i detyrueshëm është trajtimi i tyre në lanfillin/incineratorin rajonal. Ky trajtim do të ketë një kosto financiare e cila duhet të parashikohet nga ana e Bashkisë.

Për realizimin e kësaj skeme do të ketë disa sfida dhe vështirësi.

- Mbetjet e pandara të cilat do vijnë në stacionin e transferimit nuk janë të pastra, sidomos qelqi (i thyer) dhe është e vështirë të ndahet. Do të kemi përsëri një pikë të nxehtë mjedisore e cila në një të ardhme do të rehabilitohet. Për këtë qëllim duhet një analizë e detajuar e përbërjes së mbetjeve për të analizuar më pas dhe efektivitetin ekonomik për të realizuar ndarjen e mbetjeve në këto pika apo jo.
- Menaxhimi dhe administrimi i stacionit të transferimit mund të kryhet nga sipërmarrës privatë ose nga vetë bashkia.
- Për këtë qëllim do të duhet që kjo skemë të parashikojë të dyja variantet: **1) variant me stacion transferimi** për depozitim provizor të mbetjeve deri në transportin final në lanfillin/incineratorin familjar, **2) varianti i funksionimit të stacionit të transferimit** edhe si pikë për ndarjen e mbetjeve. Analiza e të dy këtyre varianteve nën skemën 1 do të na japë mundësinë e zgjedhjes së variantit më të mirë.

Ndërkohë, paralelisht me skemën, mund të fillojë dhe të aplikohet dhe pilotimi i kompostimit të mbetjeve organike, duke filluar me fshatrat të cilat kanë aktivitet të madh bujqësor. Skema edhe në këtë rast do të jetë e njëjtë me skemën që do pilotohet për ndarjen e mbetjeve në te pakten dy fshatra. Pra, grumbullimi i mbetjeve organike do të bëhet i diferencuar në këto fshatra, dhe do të depozitohen për kompostim në vende në afërsi të pikave tranzitore ekzistuese më afër këtyre fshatrave. Pas kryerjes së procesit të kompostimit, plehu organik i përfituar mund t'u jepet përsëri fermerëve që kanë aktivitet agrikulturne me pagesë ose falas, në varësi të skemës financuese që do përdoret për procesin e transportit dhe kompostimit të mbetjeve organike.

Kjo skemë mundet të funksionojë dhe në bazën e aktivitetit të vetë fermerëve, por duhet iniciuar dhe mbështetur nga Bashkia Mat.

Në të dyja rastet nga ana e Bashkisë Mat duhet të përdorën dhe mekanizmat fiskale, si nxitës së proceseve të kësaj kategorie. Konkretisht, Bashkia duhet të përdorë tarifë të diferencuar për menaxhimin e mbetjeve, për familjet të cilat do të bëjnë ndarjen e mbetjeve në burim.

Njëkohësisht nga ana e bashkisë duhet të ketë dhe financime për mjete dhe paisje (qese, kosha, materiale për kompostim) të cilat do i japin nxitje procesit dhe do sigurojnë suksesin e realizimit të skemës.

Një skemë e ngjashme mund të aplikohet edhe për mbetjet e kompostueshme, të cilat propozohet që në qytet të krijohen disa pika për mbetjet e gjelbërta, kryesisht të dala nga oborret e shtëpive dhe krasitjet e pemëve, ndërsa në zonat rurale kompostimi i tyre mund të kryhet në vend, duke parë mundësinë e sipërfaqeve të lira ose të përdorshme për kompostim të mbetjeve organike për çdo fshat.

Në qytet vendosja e pikave për mbetjet e gjelbërta mund të realizohet me kontenerë të hapur me profil metalik dhe me rrjetë teli duke lejuar mundësinë e hedhjes në to të mbetjeve të gjelbërta voluminoze (degë pemësh, gjethe etj) dhe duke kryer largimin e tyre një herë në 2-3 ditë në periudhën kur kryhen shërbimet e sipërfaqeve të gjelbëruara.

Kosto Skenari 1

Ky skenar përveç kostove të skenarit zero që është skenari aktual përfshin investimin në 25 kontenerë të rinj 1.1m³ me kosto 30.000 lekë per cop, blerjen e një mjeti teknologjik me kapacitet mesatar, shtimin e itinerarit me 14.5 km si dhe blerjen e rreth 50 kosha 20-30 litroshë për zonën me dendësi të lartë banimi. Gjithashtu në këtë skenar përfshihet rehabilitimi i venddepozitimeve aktuale ndërtimi i pikës së transferimit të mbetjeve që shërben edhe si pikë për diferencimin dhe selektimin e tyre si dhe investimin në skemat e kompostimit të mbetjeve. Duke llogaritur si rezultat, ky skenar ka një kosto vjetore prej 25.000.000 lekë në vit ose rreth 10% me të lartë se kostoja aktuale që shpenzon Bashkia Mat. Kostoja vjetore shtesë është llogaritur pa përfshirë vlerën e investimit e cila duhet investuar në vitin e parë në vlerë prej 15.000.000 lekë. Pra kostoja vjetore është llogaritur si shumë e koston së operimit të stacionit të transferimit dhe ndarjes së mbetjeve, shtesës së itinerarit të mjeteve si dhe kostove të amortizimit të kontenerëve, makinës teknologjike të re si dhe kostoja e amortizimit të stacionit të transferimit dhe ndarjes së mbetjeve.

Analiza e kësaj kostoje është si më poshtë:

- Kosto prej 1.640 lekë/ton/vit.
- Kosto prej 730 lekë/banor/vit.

Nga sa vihet re në këtë skenar nuk ka kosto vjetore të larte për vënien e tij në funksionim. Ndërkohë vlera e investimeve të nevojshme për vitin e parë është në nivele të konsiderueshme.

Skenari 2- Skenari i Skemës së diferencimit të mbetjeve në burim në qytet dhe në zonën rurale.

Kjo skemë parashikon menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane në mënyrë graduale. Në zbatim të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" dhe V.K.M.-së nr. 148, datë 27.5.2020 "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035", të gjitha bashkitë duhet të kishin filluar tashmë me skemat e menaxhimit të integruar të mbetjeve nëpërmjet ndarjes në burim. Nga ana tjetër ndarja në burim e mbetjeve të riciklueshme dhe kompostueshme do të ulte ndjeshëm kostot që ka sot Bashkia Mat për menaxhimin e mbetjeve.

Për këtë qëllim propozojmë skenarin 2 i cili parashikon fillimin e ndarjes në burim të mbetjeve duke filluar me zona pilot në disa pjesë të qytetit me mundësi shtrirje të vazhdueshme. Ndërkohë që në zonat rurale propozohet ofrimi i shërbimit në disa fshatra duke grumbulluar mbetjet "derë më derë" me grafik për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme me vete dhe mbetjeve të tjera në ditë tjetër.

Në qytet, propozohet që në disa zona, fillimisht të vogla, të kryhet vendosja e kontenerëve të ndarë, gjithsej 4, për letër, qelq, plastikë dhe mbetje të tjera. Oraret e largimit të mbetjeve do të jenë të ndryshme për kategoritë e ndryshme të mbetjeve (kryesisht frekuenca 1 herë në ditë për mbetjet familjare dhe 1 herë në 2-3 ditë për mbetjet e riciklueshme). Përzgjedhja e zonave do fillojë kryesisht në pjesët ku ka më shumë biznese, me të cilat është më praktike për të punuar pasi një pjesë e mirë e tyre kryejnë procesin e ndarjes së mbetjeve në burim, duke tentuar shtrirjen graduale në gjithë qytetin.

Të përcaktohen dy ditë të javës me orar të përcaktuar për mbledhjen e mbetjeve familjare dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme një ditë në javë. Modaliteti i ndarjes së mbetjeve të riciklueshme në letër, plastikë dhe qelq mendojmë

se në zonat rurale nuk ka efekt për shkak të sasisë së vogël që duhet të ketë në zonat rurale. Në zonat rurale bashkia mund të përzgjedhë mundësitë e grumbullimit të mbetjeve me mjete teknologjike megjithëse ka kosto të lartë dhe nuk është praktike.

Në këto zona pilot mund të krijohet mundësia e kontraktimit të një ricikluesi (të cilët sot janë informalë) i cili të kryejë këtë shërbim duke përfituar për vete mbetjet e riciklueshme, ndërkohë që bashkia përfiton kryerjen e shërbimit pa asnjë kosto, duke qenë se individit që do kryejë mbledhjen e materialeve të riciklueshme do kryejë pa pagesë grumbullimin e mbetjeve familjare. Gjithsesi çdo zonë e pilotuar kërkon një analizim më vete për të parë eficiencën e çdo modaliteti që propozohet.

Kjo skemë për realizimin e shërbimit në të gjitha variantet e propozuara më sipër ka disa sfida të cilat duhen marrë parasysh si për çështje të vështirësive praktike në realizim ashtu dhe për aspekte të kostove financiare të nevojshme për t'u realizuar.

Konkretisht:

- i. Ndarja e mbetjeve në burim është një sfidë shumë e madhe pasi kërkon një bashkëpunim të ngushtë të komunitetit dhe përcaktimin dhe aplikimin e masave shtrënguese administrative shumë strikte. Për këtë qëllim është e domosdoshme të bëhet fushatë e gjerë sensibilizimi, jo vetëm me materiale publicitare por me takime derë më derë, forume qytetare, aktivizim të shoqatave, etj. Të gjitha këto aspekte përveç vështirësisë organizative për ngritjen e rrugëve komunikuesë dhe aktivizimin e ndërgjegjës qytetare kanë dhe kosto financiare të konsiderueshme.
- ii. Nga ana tjetër mund të aplikohen dhe skema lehtësimesh fiskale ose stimuluese financiare për të bërë të mundur realizimin e skemës. Konkretisht duhen analizuar mundësia e lehtësimit të tarifës për banorët/bizneset të cilat kryejnë ndarjen e mbetjeve në burim, sikundër mund të financohen edhe iniciativa mjedisore për biznese pa ndotje, etj. Gjithsesi, realizimi i kësaj skeme ul ndjeshëm kostot e shërbimit për bashkinë duke bërë uljen e sasisë së mbetjeve dhe uljen e financimit në gjithë procesin e menaxhimit të mbetjeve duke filluar me transportin, stacionin e transferimit (ku nuk është më e nevojshme të kryhet ndarja e mbetjeve) transportin për në landfillin/incineratorin rajonal dhe koston e depozitimit final.
- iii. Realizimi i skemës kërkon një koordinim shumë të mirë dhe me kompanitë ricikluese për tërheqjen e mbetjeve të riciklueshme që do rezultojnë nga procesi i menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet kësaj skeme. Sidomos në fazat e para të aplikimit me zonat pilot, ku dhe sasia e mbetjeve të riciklueshme do të jetë e vogël duhet rakordim për të gjetur zgjidhje ku do magazinohen mbetjet e riciklueshme. Ndërkohë mund të vlerësohet mundësia e aktivizimit ose formalizimit të tregut informal të ricikluesve nëpërmjet projekteve me donator për këtë kategori. Në këtë mënyrë do t'i jepej zgjidhje dhe këtij problemi. Një mundësi tjetër për funksionimin e skemës është dhe bashkëpunimi me Dhomën e Tregëtisë e cila mundet të sigurojë informacion për bizneset në zonë të cilat kanë mundësinë të ripërdorin/riciklojnë kategori të caktuara mbetjesh. Në këtë mënyrë është e mundur të vihet në funksionim një skemë e ekonomisë qarkulluese rajonale që do japë siguri për vazhdimësinë e procesit.
- iii. Vënia në funksionim e kësaj skeme do të kërkojë dhe një vlerë financiare, investimi fillestar për blerjen e koshave, për ndarjen e mbetjeve. Ndërkohë në zonat rurale ku propozohet shërbimi "derë më derë" duhet analizuar mundësia e shpërndarjes së qeseve të veçanta për llojet e ndryshme të mbetjeve për çdo familje. Të dyja këto duan një analizë financiare për të parë kush nga mundësitë është më efiçente. Pilotimi i kësaj skeme vetëm në disa zona do të krijojë kosto shtesë edhe për transportin e mbetjeve duke qenë se do përdoret kjo skemë vetëm për një sasi të ulët mbetjesh të riciklueshme.

Për mbetjet familjare, në këtë skenar propozohet trajtimi i njejtë me skenarin 1, por pa procesin e ndarjes/selektimit të mbetjeve në stacionin e transferimit pasi është proces i panevojshëm.

Kosto Skenari 2

Ky skenar përfshin kostot e skenarit 1 si dhe koston e aplikimit të skemës pilot të diferencimit të mbetjeve në burim në qytet dhe në zonën rurale. Për aplikimin e kësaj skeme në gjithë territorin e Bashkisë Mat, është llogaritur kostoja e parashikuar në Manualin e Hartimit të Planeve Lokale të Mënaxhimit të Mbetjeve nga DLDP - Helvetas, pra me një rritje 25% e koston së shërbimit të skenarit 1 si dhe vlera e amortizimit të kontenerëve shtesë të nevojshëm për sistemin me 2 kosha.

Si rrezultat i kësaj kostoja vjetore e këtij skenari është **rreth 30.000.000 lekë/vit** ose rreth 25% më e lartë se skenari 0 dhe rreth 30% më e lartë se skenari 1. Ndërkohë kostoja e investimeve në vitin e parë të aktivitetit arrin në vlerën rreth **30.000.000 lekë** së bashku me investimet e nevojshme për skenarin 1 ose **15.000.000 lekë** investime vetëm për skenarin 2 e cila është vlera e rreth 300 kontenerëve të rinj për të plotësuar sekmat e PGM-ve me 2 kosha për të realizuar skemën e ndarjes në burim. E analizuar sipas komponenteve kosto paraqitet si më poshtë:

- Kostoja për cdo ton mbetje është 2.384 lekë/vit.
- Kostoja për cdo banor është 861 lekë/banor/vit.

Gjithësesi këto kosto mund të reduktohen nëse bëhen përzgjedhje të skemave “derë më derë” për grumbullimin e mbetjeve të ndara në burim në zonat rurale.

Skenari 3- Skenari i aplikimit të tarifës progressive.

Ky skenar është një skenar i cili nuk ka pothuajse asnjë ndryshim me skenarin 3 por i shtohet tarifimi progresiv i cili synon aplikimin e tarifave të veçata për çdo konsumator duke përfshirë të gjithë targetgrupet sociale. Ky skenar mundohet të bëjë një menaxhim më të mirë me përfosmancë më të lartë me anë të përmirësimit të mënaxhimit financiar që i bëhet këtij shërbimi. Në këtë mënyrë si sfida për këtë skenarë janë:

- Hartimi i analizave financiare për shërbimin dhe vendosjen e tarifës për secilin targetgrup konsumatorësh në lidhje me sasinë e llojin e mbetjeve të prodhuara.
- Përthitja e fondeve për palikimin dhe zbatimin e programit të tarifimit progresiv.
- Hartimi i një plani veprimi për aplikimin dhe zbatimin e tarifës progresive për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Mat.
- Krijimi i Databazës së të dhënave monitorimi dhe përditësimi i saj me informacione.
- Zhvillimi programit kompjuterik për llogaritjen dhe arkëtimet e kësaj tarife.

Kosto Skenari 3

Sa i përket kostove të këtij skenari përfshihen kostot e llogarituara në skenarin 2 si dhe kostot për aplikimin e tarifës që kanë të bëjnë më ndërtimin e softëarit për menaxhimin financiar të mbetjeve apo përgatitjen e bazës material dhe burimeve njerzore për menaxhimin në total të shërbimit më anë të kësaj tarife. Duke konsideruar se burimet njerzore mund të shfrytëzohen ato që ka Bashkia Mat në dispozicion kostoja e llogaritur vjetore shtohet me vlerën e rreth 200.000 lekë/vit si kosto për mirëmbajtjen e softëar-it ose në total arrin në vlerën **40,200,000 lekë/vit**. Kostoja e investimeve në vitin e parë së bashku me investimet e parashikuara në skenarin 1 dhe 2 arrin në vlerën 40.000.000 lekë. Ndërkohë analiza sipas elementëve rezultojn si më poshtë:

- kosto për ton në vlerën 2.389 lekë/ton/vit
- kosto për banor në vlerën 863 lekë/banor/vit.

Ky është edhe skenari më i kushtueshëm i cili përfshin të gjitha projektet strategjike të hartuara nga plani.

V. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

5.1 VIZIONI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE PËR BASHKINË MAT

Bashkia Mat vlerëson si vizion drejtues dhe orientues për punën e saj në drejtim të përmirësimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve si më poshtë:

“Bashkia Mat me fokus zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, bujqësor dhe blegtoral rajonal me standarde të larta të menaxhimit të mbetjeve në drejtim të reduktimit të mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit, riciklimit dhe kompostimit.”

5.2 OBJEKTIVAT KRYESORË TË PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE, BASHKIA MAT

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Mbetjeve kanë përcaktuar 3 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2010-2015 dhe 2015-2020) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe faza e tretë (2020-2025) ku synohet arrija e standardeve dhe objektivave të BE.

Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradualisht drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Në fazën e parë (para-pranimit), plani do të adresojë nevojat lokale për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Fokusi në këtë fazë do të jetë në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës bashkiake për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit si dhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara. Manaxhimi në nivel lokal do të përfshijë zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për dorëzim final në landfill. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave bashkiake për manaxhimin e mbetjeve.

Në fazën e dytë (faza e pas pranimit) synimet do të jenë në arritjen e objektivave strategjike kombëtare, në përputhje me standardet e legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe principet për të minimizuar sasinë e mbetjeve që shkojnë në landfill.

5.3 OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PLANIT

Në vijim të përmbushjes të vizionit të planit si dhe synimeve të Bashkisë për përmbushjen e objektivave kombëtarë, u përcaktuan objektivat lokale për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, si më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në zonat rurale duke optimizuar levizjen e mjeteve dhe shpërndarjen e PGM-ve.
- Vendosja e një sistemi për ndarjen në burim të mbetjeve si dhe organizimin e skemave të ekonomisë qarkulluese si një zgjidhje efikase për reduktimin e mbetjeve që trajtohen në landfille duke parë dhe shfrytëzuar mundësitë për riciklimin e tyre ose që mund të shërbejnë për lëndë djegëse alternative për operatorët privatë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm duke synuar vënien në funksionim

të skemave të ndarjes së mbetjeve në burim.

- Rehabilitimi i vend depozitimit ekzistues duke larguar pjesën më të madhe të depozitimeve dhe duke minimizuar ndikimin negative të mbetjeve në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve.
- Vënia në funksionim e pikave të kompostimit në zonat bujqësore si mënyra më e mirë e menaxhimit të mbetjeve në këto zona.
- Eficentimi i sistemit fiskal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve me aplikimin e tarifës progressive duke respektuar parimin “ndotësi paguan”.
- Prodhimi i Lëndëve Djegëse Alternative nga mbetjet e ngurta urbane të cilat kanë kaluar më parë procesin e riciklimit (dhe tregtimi i tyre).

5.4 RREGULLORE BASHKIAKE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE

Qëllimi

- 1) Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Objekti i rregullores

- 2) Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Mat duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, pa përfshirë trajtimin e mbetjeve, për mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbetje dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për banorët e Bashkisë.

Përcaktimi i termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

- 3) “mbetje e ngurte”: janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.
- 4) “administrim”: grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe trajtimi i mbetjeve, duke përfshirë edhe kontrollin e këtyre operacioneve, për më tepër edhe kontrollin e fushave të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit mbas mbylljes së aktivitetit.
- 5) “prodhuesi i mbetjeve”: është personi fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilit krijon, prodhon mbetje.
- 6) “grumbullimi i mbetjeve urbane” quhet procesi i pranimit, seleksionimit dhe rigrupimit të mbetjeve në vende të caktuara.
- 7) “grumbullim i diferencuar”: grumbullimi i përshtatshëm për rigrupimin e mbetjeve urbane në fraksione merceologjike homogjene, duke përfshirë fraksionin organik të lagësht, të destinuar për ripërdorim, për riciklim dhe rikuperim të lëndës së parë.
- 8) “dorëzimi” quhet nxjerrja dhe hedhja e mbetjeve urbane nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve urbane,
- 9) “largimi publik i mbetjeve urbane” quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane.
- 10) “administrator i mbetjeve”: Shoqëria/ndërmarrja, e së cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, liçencave (leje),

Bashkia i beson dhe/ose lejon administrimin e mbetjeve.

- 11) “mbetje të papranueshme”, janë mbetjet e rrezikshme a të vëllimshme, të cilat administrohen me ligje të veçanta.
- 12) “mbetjet e rrezikshme” janë mbetjet toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përlakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja në shëndetin e njeriut dhe në ekosistemet natyrore.
- 13) “vend-depozitimi” i mbetjeve është një sipërfaqe toke e caktuar nga organet e qeverisjes vendore për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.
- 14) “groposje përfundimtare (asgjësim): përfshin proceset, pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbetjes dhe që mbyllet me groposjen e hedhurinës.
- 15) “përpunim i mbetjes”: është ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes duke e transformuar atë në produkt përfundimtar ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare.
- 16) “rikuperim”: operacionet për të siguruar shfrytëzimin e mbetjeve për përfitimin e produkteve, lëndëve të para ose prodhimin e energjisë.
- 17) “riciklim i mbetjes”: ripërtëritja ose rinovimi i vetive të mbetjes për t’u përdorur me pas si lëndë e parë ose si material ndihmës.
- 18) “stokimi i mbetjeve”: quhet procesi i ruajtjes (depozitimit) të produktit pas përpunimit të mbetjes deri në destinacionin përfundimtar.
- 19) “zonë e kontratës” quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhe, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të mbetjeve ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe atyre që mund të shtohen gjate kohështrirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.
- 20) “zonë e larges” quhet shërbimi i larges së rrugëve dhe në disa raste të trotuareve.

Procesi i administrimit të mbetjeve urbane

- 21) Procesi i administrimit të mbetjeve synon që:
 - Të rezultojnë sa më pak mbetje nga veprimtaritë prodhuese.
 - Në mbetjet e krijuara, të zënë vendin kryesor mbeturinat e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme.
 - Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.
 - Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbetjeve me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis.
 - Mbetjet t’i nënshtrohen sa më shumë riciklimit dhe përpunimit.
 - Të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara mbetjet në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme.
 - Të mos pengohet përdorimi i mëtejshëm i mbetjeve nga trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme;
 - Të pakësohet sa më shumë lëvizja dhe transporti i mbetjeve dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më

të afërt.

- Të parandalohet ndotja nga mbetjet dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh.
 - Të ruhen sidomos burimet natyrore nga ndikimet e mbetjeve.
 - Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizikë dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve.
 - Të kryhet gpropose e sigurtë për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbetjeve.
 - Të mënjanohet çdo dëm a rrezik për shëndetin, mirëqënien dhe sigurinë e jetës së personit.
 - Të garantohen kërkesat higjieniko-shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane.
 - Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peisazhi nga degradimi.
- 22) Të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre nga krijuesit janë pronë shtetërore.

Fazat e procesit të administrimit të mbetjeve urbane

- 23) Procesi i administrimit të mbetjeve përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga krijuesi, dorëzimin sistematik në kazan, transportimin nga kazanet për në vend-depozitim, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin përfundimtar në vend-depozitim.

Klasifikimi i mbetjeve

- 24) Në funksion të kësaj rregulloreje mbetjet ndahen në kategoritë e mëposhtme:
- a) Mbetje urbane;
 - b) Mbetje industriale;
 - c) Mbetje të vëllimshme;
 - d) Mbetje bujqësore;
 - e) Mbetje spitalore;
 - f) Mbetje të ndërtimit;
 - g) Mbetje në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza etj.
- 25) Sipas origjinës së prodhimit mbetjet ndahen në: Mbetje Urbane dhe Mbetje Speciale dhe sipas karakteristikave të rrezikshmërisë në: Mbetje të rrezikshme dhe Mbetje jo të rrezikshme.
- 26) "Mbetje Urbane": quhen mbetjet e shtëpive, të ndërtesave administrative, sociale dhe publike. Në këtë emërtim përfshihen edhe mbetjet që vijnë si rezultat i veprimtarive tregtare dhe shërbimit, vendeve të pushimit dhe argëtimit, sasisë dhe përbërjet e të cilave nuk pengojnë administrimin e tyre bashkë me mbetjet urbane.
- 27) Mbetje speciale janë:
- a) "mbetje nga aktivitete industriale", ku përfshihen edhe mbetjet e vëllimshme nga këto
 - b) aktivitete;
 - c) "mbetjet nga aktivitetet bujqësore";
 - d) "mbetje spitalore";
 - e) Mbetjet e krijuara nga "aktivitete ndërtimi" ose prishjesh";
 - f) Mbetje jo urbane nga "aktivitete artizanale", "tregtare" apo "shërbimi".

- 28) “Mbetje Industriale”: quhen mbetjet e ngurta të krijuara si rezultat i prodhimit apo proceseve industriale, dhe që nuk bën pjesë në mbetjet e rrezikshme. Mbetje të tilla mund të përfshijnë mbetjet që gjenerohen nga linjat prodhuese për: energjinë elektrike; hekurin dhe çelikun; plastikën dhe rezinat; letrën; produkte gome; produkte guri, qelqi dhe qeramike; prodhime tekstile; mjete transporti, por nuk janë të kufizuara nga to. Ky term, në këtë rregullore, nuk përfshin mbetjet e industrisë minerare dhe asaj të naftës dhe gazit.
- 29) “Mbetje të vëllimshme” quhen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si, elektroshtepiake, pajisje informatike, mobilje, pjesë autoveturash, penobetone, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre.
- 30) “Mbetje Bujqësore”: quhen mbetjet e krijuara nga kultivimi i bimëve dhe mbarështimi mbajtja e kafshëve.
- 31) “Mbetje Spitalore” quhen: “mbetjet patologjike” antropogjene, që dalin nga operacionet e autopsisë; “mbetjet mikrobiologjike”, që përfshijnë kulturat e mbjella me agjentë të ndryshëm mikrobiologjikë. Këtu përfshihen edhe kulturat e laboratoreve mjekësore, patologjike, farmaceutike, kërkimore - shkencore, industriale dhe të bizneseve; “mbeturinat e mprehta” që përfshijnë gjilpërat, shiringat, thikat e operacioneve.
- 32) “Hedhurinë” (mbetje të fundme) nga aktivitetet e rekuperimit dhe trajtimit të mbetjeve, baltat e prodhuara nga procesi i pastrimit dhe trajtimeve të tjera për ujin dhe filtrimin e ujërave të turbullta dhe nga shembja e shtretërve të lumenjve.
- 33) “Mbetje të rrezikshme”: nga përdorimi shtëpiak, janë:
 Bojëra për lyerje, bojra shkrimi, ngjitës, tretës, produkte fotokimike, pesticide, mbajtës bosh të etiketuar “T”, “C” dhe/ose “F” dhe bombula spray, bateri dhe pila, batëri makinash, ilaçe, shiringa, aksesore për informatikën, vajra minerale, vajra vegjetale, tuba fluorishent dhe çdo lloj mbetjeje me përmbajtje mercuri.

Mbetjet objekt i rregullores

- 34) Objekt i kësaj rregulloreje janë Mbetjet Urbane.
- 35) Në funksion të kësaj rregulloreje, Mbetjet Urbane i ndajmë në dy kategori:
- A. Mbetjet Urbane të Riciklueshme - të cilat përfshijnë mbeturina që mund të ripërdoren ose riciklohen (mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë). Në këtë kategori përfshihen:
- Mbetjet metalike;
 - Mbetjet e lulishteve, kopshteve;
 - Mbetjet plastike;
 - Letrat dhe kartonat;
 - Shishet e qelqit (qelqurinat) etj.
- B. Mbetje Urbane të pariciklueshme - si p. sh., mbetje ushqimore dhe kuzhine me përbërje të fermentueshme etj, të cilat përmbledhin të gjitha mbetjet urbane, që nuk përfshihen në kategorinë e Mbetjeve Urbane të Riciklueshme.
- 36) Mbetjet që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në Mbetjet Urbane, si për shembull: mbetjet e rrezikshme, mbetjet ndërtimore dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, që specifikohen nga Bashkia përkatësisht për secilën prej mbetjeve. Bashkia mund të ofrojë pika alternative për grumbullimin e tyre pranë zonave të banimit.

5.4.1 Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve

Të përgjithshme

- 37) Autoritetet e Bashkisë, me asistencën apo bashkëpunimin e strukturave përkatëse rajonale, si përfaqesuesit e inspektoriatit sanitar shtetëror të rrethit, përfaqesuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së mjedisit dhe ata të ndermarrjes/sipërmarrjes së pastrimit, përcaktojnë dhe publikojnë grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve.
- 38) Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve bëhet përgjithësisht një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e mbrëmjes, kur është ulur ndjeshëm aktiviteti urban. Gjatë ditës pastërtia sigurohet duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët e trotuarët, hedhurinat e ngurta të kalimtareve si dhe ndotjet e tjera.

Pastrimi i territoreve

- 39) Hapësirat dhe territoret private pastrohen nga vetë pronarët e tyre.
- 40) Hapësirat e zbuluara publike që nuk janë të përfshira në skemën e pastrimit të qytetit pastrohen nga institucionet, apo banoret që janë përdorues të kesaj hapësire.
- 41) Gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatore dhe ata që kryejnë veprimtari transporti, detyrohen të mbajnë pastër territorin përreth lokalit apo vendit të punës në gjerësi 5 m.
- 42) Hapësirat e zbuluara publike që përfshihen në skemën e pastrimit pastrohen nga Bashkia.
- 43) Sheshet e tregtimit pastrohen çdo ditë pas përfundimit të aktiviteteve nga administratorët apo përdoruesit e tyre.

Pastrimi dhe larja e rrugëve

- 44) Pastrimi dhe larja e rrugëve realizohet nga Bashkia, ose nga një palë e tretë e ngarkuar prej saj apo e kontraktuar për të kryer këtë shërbim.
- 45) Pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuarët e Bashkisë dhe të qendrës së banuar.
- 46) Bashkia parashikon të administrojë të gjitha sipërfaqet e gjelbra publike, të kryejë mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e territorit nga mbetjet.
- 47) Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe i trajtimit special në përputhje me normat higjieno-sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.
- 48) Frekuenca e shërbimit të pastrimit përcaktohet nga Bashkia sipas nivelit të ndotjes që shkaktohet.
- 49) Mbeturinat që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.
- 50) Ndalohet kategorikisht hedhja e mbetjeve që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, në pusetat e telefonisë, në pusetat e ujësjellësit, në pusetat e ujërave të zeza, në pusetat e hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujërave atmosferike, në shtreterit e ujërave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Koshat rrugorë

- 51) Me qëllimin për të garantuar mbajtjen pastër të hapësirave publike mund të vendosen dhe të administrohen, nën kujdesin e Bashkisë, kosha rrugor për mbetje të dimensioneve të reduktuara të prodhuara nga kalimtarët.
- 52) Kalimtarët, mbeturinat e gasit, si ambalazhe te ndryshme, i dorezojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

Pastrimi i pusetave dhe dorëzimi i mbetjeve të pastrimit

- 53) Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve, bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.
- 54) Përpara sezonit të shirave kryhet pastrimi i të gjitha pusetave të ujërave atmosferike, për të siguruar në vazhdimësi transportimin e tyre. Mbas çdo pastrimi, hiqen menjëherë mbeturinat që dalin nga pastrimi dhe kryhet dezinfektimi përreth pusetës me lëndë dezinfektuese ose pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori.
- 55) Mbeturinat e nxjerra nga pastrimi i pusetave largohen menjëherë nga subjekti përgjegjës dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ndotja e hapësirave publike

- 56) Kush kryen operacione ose/dhe aktivitete, të cilat mund të sjellin ndotjen e hapësirave publike është i detyruar në mënyrë konstante të mbajë të pastër ato çka përmendëm më sipër, në çdo rast, dhe të mos lërë asnjë mbetje të çfarëdo lloji.
- 57) Ndalohet hedhja dhe derdhja në trotuar, rrugë e sheshe të qendrave të banuara e mbetjeve dhe ujërave që dalin nga pastrimi ose larja e lokaleve të shërbimit publik.

5.4.2 Veçimi, sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve urbane

Veçimi dhe sistemimi i mbetjeve

- 58) Në rastet kur Bashkia ofron shërbimin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve, familjet si dhe subjektet publike a private që gjatë veprimtarisë së tyre krijojnë mbetje, i veçojnë ato në grupe si:
 - a. Mbetje ushqimore,
 - b. Ambalazhe (plastike, qelq, letër, karton),
 - c. Mbetje ndërtimore (llaç, tulla, beton, dhera),
 - d. Objekte të vëllimshme (karrige, tavolina, kolltuqe, etj).
- 59) Secili grup trajtohet e ambalazhohet më vete, në kosha të veçantë.
- 60) Mbetjet e vëllimshme (si automjete, makineri, pajisje) çohen nga pronarët në vendin e posatshtëm për depozitimin dhe përpunimin e tyre. Braktisja e tyre jashtë vendeve të përcaktuara, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
- 61) Të gjitha subjektet që në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre krijojnë lloje të ndryshme mbetjesh, janë të detyruara të kenë më shumë se një kosh për grumbullimin e ndarë të tyre.

- 62) Koshat janë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbetjeve. Koshat vendosen në vende të dukshme dhe lehtësisht të përdorshme.
- 63) Spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët, farmacitë, klinikat stomatologjike, shtetërore a private, detyrohen të përdorin sistemin e disa koshave për mbeturinat, njëri prej të cilëve është për mbeturinat e rrezikshme spitalore që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë.
- 64) Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, mund të përdorin sistemin e disa koshave për të edukuar nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbetjeve.

Dorëzimi i mbetjeve urbane

- 65) Sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve nga familjarët dhe nga të gjitha subjektet e tjera, bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbetjeve që ka caktuar Bashkia ose me kontenierë individuale që përcaktohen sipas llojit të prodhuesit, sasisë së mbetjeve dhe infrastrukturës. Dorëzimi i tyre jashtë rregullave të përcaktuara nga Bashkia, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
- 66) Tregtarët dhe persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosh të posatshëm për grumbullimin e mbetjeve, që krijohen gjatë tregtimit e shërbimit që u ofrojnë qytetarëve.

Përdorimi i kontenierëve publikë

- 67) Mbështetur në Ligjin Nr. 8094 dt.21.03.1996, kanë të drejtë të përdorin kontenierët publike:
 - a) Familjet, brenda vijës së verdhë të Bashkisë.
 - b) Bizneset, të llojit tregtar, artizanal apo shërbimesh, që prodhojnë mbetje urbane, ku prodhimi ditor i çdo subjekti nuk kalon sasinë prej 25 % e vëllimit të një kontenieri publik, përcaktuar në Nenin 12 të ligjit Nr.8094 dt.21.03.1996.
- 68) Të gjithë bizneset apo institucionet private apo shtetërore që prodhojnë mbetje mbi kufizimin e mësipërm, duhet të kenë detyrimisht kontenierë individual brenda territorit të tyre.

Kufizimet për dorëzimin e mbetjeve urbane

- 69) Dorëzimi i mbetjeve është një detyrim i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orareve të përcaktuara nga Bashkia si dhe mbështetur në kategorizimin e mbetjeve dhe prodhuesve të përcaktuar në këtë rregullore.
- 70) Dorëzimi i mbetjeve industriale, ndërtimore, mbetjeve të zanatit, mbetjeve të vajrave lubrifikant, si dhe mbetjeve të tjera që nuk konsiderohen si mbetje urbane nga ligji nr.8094, date 21.03.1996 “Për largimin publik të mbetjeve” dhe nga kjo rregullore, dotë bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Bashkia për këtë qëllim.
- 71) Dorëzimi i tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve të caktuara në qytet për mbetjet urbane, është e ndaluar dhe ndërshkohet.
- 72) Mbetjet ndërtimore dorëzohen në vendet e caktuara nga Bashkia për këtë qëllim. Gjatë procesit të ndërtimit, riparimit apo prishjes, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtues, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbetjeve ndërtimore.
- 73) Hedhja e mbetjeve ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia

për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndërshkohet si e tillë.

- 74) Mbetjet që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbetjeve, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanet dhe vështirësuar transportin.

5.4.3 Grumbullimi, largimi e transportimi i mbetjeve

Grumbullimi i mbetjeve

- 75) Vendet e grumbullimit të mbetjeve (VMM)-të janë sipërfaqe të vogla që shërbejnë për dorëzimin e mbetjeve nga prodhuesit e tyre. VMM-të duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara.
- 76) VMM-të ku vendosen kontenierët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbetjeve, caktohen nga Bashkia.
- 77) Këshilli Bashkiak, miraton dhe publikon skemën konkrete të vendndodhjes së VMM-ve dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vendndodhjes së VMM-ve, pa miratim të Bashkisë, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
- 78) Ofrimi dhe pranimi i shërbimit është i detyrueshëm në të gjithë territorin Bashkiak, duke mos përjashtuar askënd, vetëm në rastet kur Kryetari i Bashkisë autorizon forma të përkohshme eksperimentale të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.
- 79) Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në mënyrë jo të diferencuar ofrohet nga Bashkia në një ose disa mënyra specifike, si:
 - a. grumbullimi nëpërmjet kontenierëve publik;
 - b. grumbullimi nëpërmjet qeseve; *derë më derë*;
 - c. grumbullimi nëpërmjet dorëzimit në platforma (sheshe) Bashkiake;
 - d. grumbullimi nëpërmjet kontenierëve për hapësira private dhe të përmasave të ndryshme.
- 80) Prodhuesi i mbetjeve mund të depozitojë mbetjet në mënyrë individuale direkt në fushën e grumbullimit, në përputhje me këtë rregullore.
- 81) Shërbimi duhet të garantojë grumbullimin e të gjitha mbetjeve që për çfarëdolloj motivi gjenden jashtë kontenierëve, në pikat ku shërbimi kryhet “*derë më derë*”, si edhe grumbullimin e mbetjeve që gjenden të shpërndara në hapësirat publike.

Grumbullimi me kontenierë

- 82) Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve kryhet në hapësirat publike Bashkiake të banimit, bizneseve ose në oborre të shoqërive private a publike dhe në pergjithësi në të gjitha vendet ku është parashikuar një prodhim i konsiderueshëm mbetjesh.
- 83) Zbrazja e kontenierëve kryhet sipas një grafiku të caktuar në bazë të një kalendari operativ e që i komunikohen paraprakisht përdoruesit nën kujdesin e operatorit.
- 84) Menjëherë mbas largimit të mbetjeve territori përreth sheshit të kontenierëve pastrohet në një sipërfaqe 20-25 m². Kontenierët dezinfektohet me gelqere të kloruar (deri 5% klor aktiv) ose lëndë dezinfektuese pas zbrazjes së mbetjeve.

- 85) Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth konteniereve ose në vendet e përcaktuara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre.
- 86) Përdoruesi është i detyruar të përdorë kontenierin e disponueshëm, më të afërt dhe të mbyllë kapakun nëse kontenieri ka një të tillë; në rastet kur kontenieri është i tejmbushur nga qeset, mbetjet duhet të dorëzohen në kontenierin tjetër disponibël dhe nuk duhet të lihen asnjëherë në tokë.
- 87) Kontenierët lahen dhe dezinfektohen sipas një grafiku të miratuar nga Bashkia me lëndë dezinfektuese, dezinfektante dhe deratizuese:
 - Për kontenierët publike minimalisht një herë në javë.
 - Për kontenierët që qëndrojnë në ambiente të brendshme, publike apo private minimalisht një herë në muaj.
- 88) Lëndët dezinfektantë, dezinfektantë dhe deratizuese që përdoren për kontenierët dhe vendin përreth tyre, miratohen nga Ministria e Shëndetësisë apo institucione të varura prej saj, duke iu nënshtruar procedurave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Mjedisit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.415 dt.01.08.1993.

Grumbullimi me qese

- 89) Bashkia, në pamundësi të kryerjes së shërbimit me kontenierë publike mund të ofrojë shërbim alternativ të grumbullimit me qese të mbetjeve në zona të caktuara urbane.
- 90) Përdoruesi familjar ka detyrimin të nxjerrë jashtë banesës së tij, pranë derës ose në një vend të përcaktuar në hapësirën publike, qeset në mënyrë të dukshme, të mbyllura (lidhura), në mënyrë të rregullt, për të mos krijuar pengesa apo rreziqe për kalimtarët në orare të përcaktuara paraprakisht.
- 91) Mund të aplikohen pika grumbullimi të lëvizshme që janë mjete vetëshkarkuese të hapura të tonazhit të vogël gjithmonë me orare dhe frekuencë të përcaktuar.
- 92) Frekuenca dhe ora e grumbullimit përcaktohet nga operatori me miratimin e Bashkisë, kurse lajmërimi i orarit bëhet nga operatori i shërbimit.
- 93) Qeset duhet të jenë të të njejtit lloj dhe i shpërndahen përdoruesit nga operatori në proporcion me konsumin. Qeset duhet të jenë në peshë jo më të madhe se 20 kg dhe nuk duhet të kenë objekte që presin, me majë, gjithsesi materiale të rrezikshme për personin përgjegjës për shërbimin manual të grumbullimit.

Grumbullimi me kontenierë të palëvizshëm

- 94) Mbetjet e vëllimshme dhe të ndërtimit, të prodhuara nga ekonomitë familjare, mund të dorëzohen dhe grumbullohen, me mënyrat e përcaktuara nga Bashkia, si më poshtë vijojnë:
 - a. Nëpërmjet dorëzimit në kontenierët e palëvizshëm, me dimensione të mëdha;
 - b. Nëpërmjet grumbullimit pranë ish përdoruesit, me anë të telefonimit të administratorit;
 - c. Nëpërmjet dorëzimit pranë Qendrave të Multigrumbullimit.
- 95) Në ditën e parashikuar për grumbullim, materiali duhet të nxirret jashtë nga ish përdoruesi, në pikën më të afërt të grumbullimit, në mënyrë që të evitohet çdo pengesë ndaj lëvizjes së mjeteve dhe/ose këmbësorëve.

Shërbimi i pastrimit në tregje

- 96) Administratorët e tregjeve, persona të veçantë apo grup personash tregtarë që zënë vendet e shitjes në tregjet private apo publike, të organizuar në hapësirat publike ose private, duhet të administrojnë vetë-pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Për sa i përket administrimit të mbetjeve që dalin këto tregje duhet të operohet si më poshtë:
- a) Administratori i tregut privat apo përfaqësuesi i tregtarëve është përgjegjës për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve për në fushën e depozitimit, duke lidhur detyrimisht kontrata të veçanta me bashkinë ose operatorë privatë, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjieno- sanitare të kësaj rregulloreje.
 - b) Në rastet e tregjeve publike që administrohen nga Bashkia, ky shërbim përfshihet në shërbimet e tjera të pastrimit që administron Bashkia.
 - c) Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga Bashkia "VMM" të përkohshëm ose të përhershëm, brenda territorit të tregut, për të mundësuar vendosjen e kontenierëve.
- 97) Të gjithë shitësit e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbetjeve që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbetjeve është shkelje, që ndëshkohet me moslejimin për të tregtuar përsëri në treg.

Grumbullimi i mbetjeve të imëta bimore

- 98) Grumbullimi i mbetjeve të imëta bimore kryhet nëpërmjet dorëzimit pranë vendeve të përcaktuara nga Bashkia, në kontenierët publikë të mbetjeve urbane ose me shërbim grumbullimi "derë me derë".

Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve

- 99) Kontenierët parashikohen në numer të tillë, që të sigurojnë grumbullimin në kohë dhe në sasi, midis flukseve të çdo cikli dorëzimi.
- 100) Caktimi i VMM-ve, duhet bërë duke respektuar kriterët e higjienës, aty ku është e mundur në një distancë prej 10 metrash, largësi (vijë) ajrore nga dyert dhe dritaret, në harmoni me infrastrukturën urbane, për më tepër me qëllim lehtësimin e operacionit të zbrazjes dhe tërheqjes.
- 101) Për të gjitha ndërtimet e reja, projektet e rikonstruksioneve apo zonave të reja urbane përcaktimi dhe miratimi i vendeve të grumbullimit të mbetjeve është i detyrueshëm dhe bëhet në përputhje me Nenin 29 të Ligjit 8094 dt. 21.03.1996.
- 102) Kontenierët mund të vendosen brenda hapësirave private, brenda dyqaneve, tregjeve dhe pikave të shitjes me pakicë ose shumicë, apo brenda institucioneve publike, shkollave dhe qendrave sportive etj. me pëlqimin/ose jo të pronarit ose administratorit, si dhe miratimin e Bashkisë, në rastet e mëposhtme:
- a) Në zonat ku struktura urbanistike e bën të pamundur vendosjen e kontenierëve në hapësira publike.
 - b) Në raste të veçanta nevojash të shërbimit të grumbullimit, që lidhen me:
 - Dëshirën e konsumatorit për të pasur pikë të pavarur;
 - Sasinë dhe llojin e mbetjeve që prodhon, ku përfshihen edhe mbetjet jo urbane;
 - Llojin e aktivitetit etj.

Në këto raste mund të ketë shtesë për tarifën e shërbimit që përfiton.

- c) Në rastet kur konsumatori nuk ofron pëlqimin për të pasur kontenierë të pavarur, ai detyrohet të depozitojë mbetjet në pikën më të afërt të grumbullimit kur është në përputhje me kriterin e vendosur tek “Përdorimi i kontenierëve publik”, ose në të kundërt, duhet të bëjë vetë depozitimin e mbetjeve në fushën e depozitimit të tyre në përputhje me normat e përcaktuara në këtë rregullore.
- 103) Grumbullimi i mbetjeve që krijohen nga biznesi (i vogël, i mesëm, i madh), por që nuk përfshihen në kategorinë “mbetjeve të bizneseve” (si p.sh., tallash, xham etj.), bëhet me kontenierë privatë të vendosur brenda sipërfaqës ku kryhet aktiviteti. Kontenierët privatë duhet të kenë të njëjtat parametra, si edhe ata publikë.
- 104) Kontenierët duhet të kenë sipërfaqe të lëmuara, material me qëndrueshmëri të lartë dhe të papërshkueshëm nga uji, material metalik (trashësi të llamarinës=1.5-2 mm) apo plastik, të pajisura me kapak dhe me rrota (ose këmbë fikse), të kapaciteteve të ndryshme.
- 105) Kontenierët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga subjekti që është angazhuar me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve.
- 106) Kontenierët mund të jenë të llojeve, si më poshtë:
- a) Kontenierë të brendshëm, me kapacitet vëllimetrik prej 120/240/360 litër, kontenierë publikë urban, me kapacitet vëllimetrik prej 1,100, 2,400, 3,200 litër, për qëndrim jashtë.
 - b) Kontenierë për mbetje të vëllimshme, të palëvizshëm, pa rrota, me kapacitet vëllimetrik mbi 5,500 litra, për qëndrime fikse dhe procesi i zbrazjes kryhet në mënyrë mekanike.
 - c) Kontenierë me kompaktim, të palëvizshëm, pa rrota, me kapacitet vëllimetrik të madh, me vetëkompaktim (të pajisura me sistem hidraulik apo mekanik të pavarur).

Ruajtja higjieno-sanitare për punonjësit e shërbimit

- 107) Për ruajtjen higjieno-sanitare të punonjësve të shërbimit të administrimit të mbetjeve zbatohen normat në dispozicion për sigurinë dhe higjienën e punës. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje të përshtatshme dhe me mekanizma apo pajisje për mbrojtje personale, dhe duhet t'i nënshtrohen trajtimeve për kontrolle sanitare të parashikuara në ligj.

Transporti i mbetjeve

- 108) Transporti i mbetjeve për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj.
- 109) Transporti organizohet e funksionon në orët e mbrëmjes apo gjatë ditës.
- a) Transportimi i mbetjeve nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me mjete teknologjike të posaçme dhe të mbuluara, ngarkesa e të cilave nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve.
 - b) Kamionët që transportojnë lëndë dhe materiale ndërtimi ose që çojnë mbeturinat ndërtimore në vendet e depozitimit të tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rrjedhje të materialeve që transportojnë.
 - c) Kamionët, autoveturat etj. Kur hyjnë në rrugët e Bashkisë nga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugë dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llaçet, betonet e çdo papastërti tjetër që ndot sipërfaqet urbane.

5.4.4 Tarifat

Vjelja e tarifës

- 110) Tarifa e pastrimit vilet nga autoritetet e Bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të mbledhjes, largimit e trajtimit të mbetjeve dhe pastrimin e qytetit.
- 111) Autoritetet e Bashkisë duhet të përcaktojnë vetë ose mund të ngarkojnë një palë të trete, me përlogaritjen e tarifave, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre, lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e Bashkisë, përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni të autoriteteve.

Objekti i tarifës

- 112) Tarifat vilen për pastrimin e Bashkisë, për vënie në gjendje pune dhe përdorimin e impianteve për largimin, transportin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve.

Taksapaguesit

- 113) Niveli i tarifës përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.
- 114) Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.
- 115) Bashkia mund të aplikojë tarifa të ndryshme sipas llojeve të ndryshme të prodhuesve, duke u bazuar në shërbimin që përfitojnë, sasisë dhe llojit të mbetjeve që gjenerojnë. Mund të aplikohen gjithashtu pagesa shtese mbi tarifën për biznese të vegante ku lloji dhe sasia e mbetjeve, që prodhojnë nuk mund të përballohet nga shërbimi publik i mbledhjes së mbetjeve.
- 116) Për këto biznese mund të aplikohen zbritje të tarifës nëse marrin vetë përsipër largimin e mbetjeve. Në këtë rast mund të aplikohet vetëm tarifa për depozitimin e mbetjeve në fushat e trajtimit të tyre.
- 117) Për çdo ndryshim të masës së taksave shpallet një vendim ndryshimi. Afati i tarifës së re përcaktohet në vendimin e ndryshimit. Mospagesat trashëgohen.

5.4.5 Ndalimet, kontrolli dhe sanksionet

Ndalime dhe Detyrime

- 118) Shkeljet ndaj Rregullores ndëshkohen sipas normave e ligjeve në fuqi dhe siç është përcaktuar në Rregullore.
- 119) Përveç ndalimeve të shprehura qartë në nenet e Rregullores:
 - a) Është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin Bashkiak, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurtë, gjysmë të ngurta, e lengët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensionit, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjtë, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve etj.;
 - b) Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve në vendet e zbuluara të hapsirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbetjeve.

c) Cilido që shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryejë largimin e mbetjeve.

Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;

- a) Është e ndaluar për qytetarët dhe për këdo person të pautorizuar, të kryej çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, gërmimi apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, ose pranë impianteve të rekuperimit dhe përpunimit final;
- b) Në rastet e shërbimit të grumbullimit “derë më derë” është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe/ose kontenierëve shtëpiake që kanë mbetje, përgjatë rrugës së grumbullimit, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia;
- c) Është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- d) Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme, nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;
- e) Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve vëllimore që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensionimi, përbërja dhe karakteristika të tjera, që mund t'i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër, mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;
- f) Është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve urbane, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me menyrat e caktuara në shërbimet respektive;
- g) Është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo përmbysja;
- h) Jane të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;
- i) Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lekura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);
- j) Është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- k) Është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale, për të cilat nuk është lidhur një marreveshje e përshtatshme;
- l) Djegia e mbetjeve në kazan, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut;
- m) Ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kazaneve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbetjeve e ushqimeve për kafshët si mbeturina buke etj.;
- n) Nuk pranohet e drejta për të kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e Bashkisë.

Kontrolli

- 120) Përveç kompetencave të organizmave përgjegjës me ligj për kontroll, Bashkia aktivizon mbikëqyrjen për të respektuar Rregulloren, duke aplikuar sanksione administrative të parashikuara nga normativat në fuqi.
 - 121) Autoritetet e caktuara për kontroll janë të autorizuar të kryejnë të gjitha inspektimet, që mendojnë të nevojshme për të vërtetuar respektimin e normave të caktuara në rregullore.
 - 122) Bashkia ka të drejtën të kërkojë nga prodhuesit e mbetjeve speciale të paraqesin dokumentacionin vërtetues të përpunimit që kryhet.
 - 123) Në rastet e vërtetimit për mos respektim të rregullores, Bashkia nëpërmjet një urdhërese të motivuar nga arsye sanitare, higjienike dhe mjedisore, vendos kryerjen e punimeve të nevojshme, barrë kjo në ngarkim të subjektit përgjegjës për ndotje. Gjithashtu urdhëron adaptimin e masave oportune për të parandaluar përsëritjen e mosrespektimit të rregullores, si dhe marrjen e masave penalizuese sipas normativave në fuqi.
 - 124) Përveç mbikëqyrjes së mësipërme strukturat e Bashkisë kryejnë dhe monitorimin e shërbimit, performancës dhe objektivave të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve si më poshtë:
 - a) Monitorimi i shërbimit, kryhet çdo ditë nga mbikëqyrësi/supervizori i shërbimit sipas formularit 1.1 bashkangjitur rregullores.
 - b) Monitorimi i performancës, kryhet çdo fund muaji nga Përgjegjësi i shërbimit të Pastrimit në Bashki sipas formularit 1.2 bashkangjitur rregullores.
 - c) Monitorimi i objektivave të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve sipas formularit 1.3 bashkangjitur rregullores nga Drejtori i Punëve Publike në bashkëpunim me Përgjegjësin e shërbimit të Pastrimit.
- Çdo fillim viti Drejtorja e Shërbimeve Publike, raporton tek Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë mbi performancën e shërbimit dhe monitorimin e objektivave.
- Mbi bazën e këtij raportimi, në rastet kur është e nevojshme ata propozojnë në Këshillin e Bashkisë dhe ndryshime mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve ose mbi këtë rregullore.
- 125) Në rastet e lënies së mbetjeve në hapësirat publike ose për përdorim publik, ku nuk është identifikuar subjekti përgjegjës për ndotje, Bashkia kryen me shpenzimet vetjake grumbullimin e mbetjeve dhe përpunimin e mëtejshëm.

Sanksionet

- 126) Ndaj personave fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, zbatohen sanksionet e ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, 'Për largimin publik të mbetjeve'.
- 127) Mosrespektimi i kësaj rregulloreje dënohet sipas VKB-së Nr.78 Datë 20.12.2018, Kapitulli III, Penalitetet, tabela 7.

5.4.6 Marrëdhëniet me publikun

Detyrimi për informim

- 128) Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzimin dhe largimin publik të mbetjeve.
- 129) Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e vend-depozitimeve për njësi kompostimi

- 130) dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.
- 131) Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të largimit publik të mbetjeve sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.
- 132) Personat fizikë e juridikë që janë angazhuar në largimin publik të mbetjeve, që kanë dhe përdorin vend-depozitime apo njësi të kompostimit, publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre, jo më rrallë se një herë në tre muaj.

Procedurat e ankimimit dhe ekzekutimi

A. Marrja e Ankesës dhe Shqyrtimi

- 133) Çdo konsumator ka të drejtën e ankimimit me gojë ose me shkrim mbi procesin e largimit publik të mbetjeve.
- 134) Fillimisht të gjitha ankesat e klienteve depozitohen tek zyra e informacionit në Bashki dhe adresohen për tek drejtuesi i seksionit të shërbimeve publike.
- 135) Pala që kryen shërbimin merr çdo ditë nga seksioni i shërbimeve listën e ankesave, e cila përmban llojin dhe burimin e ankesës.
- 136) Ajo detyrohet të ndreqë shkakun e ankesës brenda 24 orësh. Në rast mosndreqjeje ajo detyrohet të japë shpjegime pranë drejtuesit të seksionit të shërbimeve brenda këtij afati, lidhur me arsyet e mosndreqjes së shkakut të ankesës.

B. Zgjidhja e Ankesës

- 137) Bashkia ka të drejtën të dërgojë një supervizor për të kontrolluar zgjidhjen e ankesës. Në qoftë se supervizori vëren mangësi, ai duhet të njoftojë palën që kryen shërbimin për keto mangësi.
- Pala duhet të njoftojë njësinë administrative kur këto mangësi janë plotësuar.
- Pala duhet të rikontrollojë punën për të parë nëse gjithçka është plotësuar në mënyrë të kënaqshme.

Manifestimet publike, panaiet, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës

- 138) Veprimtaritë e stinës, Entet Publike ose Fetare, Fondacionet apo Shoqatat, Cirqet, Partitë Politike, apo çfarëdo grupi qytetarësh që ka për qëllim organizimin e iniciativave si, festa, panaiet, festime popullore, vrapime, spektakle lëvizëse ose manifestime edhe të llojit kulturor apo sportiv etj., në rrugë, sheshe dhe hapësira publike apo për përdorim publik, janë të detyruar të sigurojnë direkt, ose nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me njësinë administrative, mbajtjen pastër të hapësirave, që i janë dhënë atyre për përdorim, si gjatë ashtu edhe në fund të iniciativës, duke dorëzuar në kontenierët e përshtatshëm të vendosur nga administratori, si mbetjet e prodhuara direkt nga aktiviteti i tyre, ashtu edhe ato të prodhuara nga frekuentimi i manifestimit prej qytetarëve.
- 139) Detyrimet suplementare të dala nga kryerja e shërbimit publik do t'i ngarkohen organizuesve të manifestimeve.

Fushatat sensibilizuese dhe informuese

- 140) Bashkia kujdeset për fushatat e nevojshme të edukimit, sensibilizimit dhe stimulimit për bashkëpunimin me komunitetin.

- 141) Në mënyrë periodike kryhet një reklamim në masë të gjërë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesëmarrjen aktive të komunitetit.
- 142) Në mënyrë periodike shpërndahet falas një broshurë me orientime, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme, për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; ndër të tjera do të jepen edhe orientime mbi fraksionet që grumbullohen, mënyrat e dorëzimit, destinacionet e tyre, mbi arsyet, nevojat dhe pretendimet e bashkëpunimit të qytetareve.
- 143) Duhet të promovohen, nga drejtoritë përkatëse në Bashki, sipas rastit në bashkëpunim me personat juridikë të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin:
- Llojet e mbetjeve për të cilat është aktivizuar shërbimi i diferencuar;
 - Qëllimin dhe mënyrat e kryerjes së shërbimeve;
 - Destinacionet e fraksioneve që rekuperohen;
 - Detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve.
- 144) Në mënyrë të veçantë promovimi mund të realizohet:
- Nëpërmjet tabelave pranë pikave të grumbullimit;
 - Nëpërmjet komunikimeve në shtyp;
 - Nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndara tek përdoruesit e interesuar;
 - Nëpërmjet formave të tjera të shpërndarjes së materialeve informuese;
- 145) Personi juridik, si administrator i shërbimit të grumbullimit është i detyruar të komunikojë çdo lloj ndryshimi në lidhje me mënyrat e kryerjes së shërbimit tek përdoruesit e interesuar me një paralajmërim verbal, minimumi 7 ditë.

Bashkëpunimi me organizma joqeveritare

- 146) Në aktivitetin e administrimit të mbetjeve urbane Bashkia mund të shfrytëzojë bashkëpunimin e shoqatave të vullnetarizmit, OJQ-ve, pjesëmarrjes së publikut etj.
- 147) Organizatat joqeveritare kryejnë kontribute të nevojshme, me qëllim ndihmën në grumbullimin në mënyrën e duhur të mbetjeve, që frymëzohen nga qëllime mjedisore, pa qëllime përfitimi duke përdorur aktivitete vullnetarizmi.
- 148) Organizatat joqeveritare që operojnë pa përfitime mund të përfshihen edhe në grumbullimin e fraksioneve specifike të rekuperueshme të mbetjeve urbane, pas nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkinë, me paraqitjen e kërkesave të nevojshme që tregojnë mënyrat e kryerjes së grumbullimit, llojet e materialeve që grumbullohen dhe destinacioni i tyre, për më tepër, edhe mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit për garantimin e higjienës dhe sigurisë së punës që do të kryhet.
- 149) Organizatat joqeveritare autorizohen nga Bashkia, e cila përcakton vendin dhe mënyrat e ndërhyrjes etj.

Zbatimi i rregullores

- 150) Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:
- Organet shtetërore dhe organizatat vendore.

- b) Gjithë individët, banorë të qytetit e të zonës, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në komunë, punonjës në organe e organizma publike e private.
- c) Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.
- d) Personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Hyrja në fuqi

151) Kjo rregullore hyn në fuqi një muaj pas shpalljes dhe publikimit lokal të saj.

VI. PLANI I VEPRIMIT

6.1 FAZIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Faza I. Periudha 2021-2025:

Në këtë fazë të parë propozohet përmirësimi i cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sidomos në 10 fshatrat ku distanca e vendbanimeve nga PGM-të është më shumë se 500 m dhe infrastruktura është me e sistemuar.

Në total për përmirësimin e shërbimit në këto fshatra është e nevojshme në këtë fazë shtesa e 25 kontenierëve 1.1 m³ dhe shtimin e 10 km itinerar. Kostoja për një kontenier 1.1 m³ metalik është 30,000 lekë, ndërsa shtimi i itinerarit prej 10 km është me një kosto të papërfillshme.

Ndërkohë në këtë fazë duhet të realizohet dhe hartimi i një studimi fizibiliteti dhe studimi teknik për ndërtimin e një stacioni transferimi. Ky studim duhet të marrë parasysh propozimin e bërë më sipër për ndërtimin e një stacioni transferimi të përbashkët me Bashkinë Klos Bulqize Diber sipas Planit të Minsitrisë Mjedisit dhe turizmit për ndërtimin e 12 landfilldeve.

Njëkohësisht në këtë fazë duhet të realizohen studimet e fizibilitetit dhe teknike për ndërtimin e pikave të kompostimit të mbetjeve organike që rezultojnë nga aktiviteti bujqësor. Këto studime mund të realizohen nga specialitetet e Bashkisë me mbështetjen e ekspertëve dhe donatorëve. Në këtë studim duhet të përfshihet dhe mundësia e funksionimit qoftë të stacionit të transferimit, qoftë e pikave të kompostimit për Bashkitë Klos dhe Mat në mënyrë që të ketë kosto të ulët dhe efikasitet ekonomik.

Përgatitja e planit të punës dhe analizimi i mundësive për ngritjen e sistemit të tarifimit progresiv të përcaktuar në VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018, "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve", shtojca 2, modeli 3. Bashkia synon të bëjë llogaritjen e tarifës sipas këtij modeli pasi respekton parimin "ndotësi paguan". Për këtë sistem është e nevojshme mbledhja dhe përpunimi i një sërë të dhënash specifike dhe të detajuara për çdo familje/biznes dhe e ka të nevojshme mobilizimin e burimeve njerëzore dhe hartimin e një plani pune të detajuar për të realizuar procesin. Në fazën e parë propozohet të hartohet një plan pune i detajuar për këtë proces.

Largimi i mbetjeve nga vend-depozitimi aktual i mbetjeve në afërsi të qytetit të Burrel. Propozohet largimi i këtyre mbetjeve në këtë fazë për të bërë të mundur minimizimin e kostove duke qenë se deri në vitin 2025 incineratori/landfilli rajonal do të depozitohet mbetje pa pagesë në bazë të kontratës konçesionare që ka Qeveria Shqiptare me konçesionarin. Gjithsesi, zhvendosja e mbetjeve të depozituara prej vitesh do ketë një kosto të konsiderueshme e cila nuk mund të vlerësohet pa kryer një analizë të detajuar mbi sasinë totale të mbetjeve që janë depozituar prej

vitesh dhe pa pasur një komunikim me administratën e incineratorit/landfillit rajonal.

Duke qenë se në fazën e parë propozohet të realizohet studimi dhe plani i punës për aplikimin e tarifës progresive propozohet që në fazë të dytë të realizohet mbledhja e të dhënave të nevojshme për çdo familje/biznes dhe të dhënat të hidhen në format excel dhe të jenë interaktive duke përditësuar çdo të dhënë dhe duke stimuluar tarifimin në këtë mënyrë.

dhe njëkohësisht dhe kërkesave të bashkive të tjera të cilat duhet dhe do duan të aplikojnë të njëjtin sistem çka mund të ulë ndjeshëm koston e softëare-it.

Në këtë fazë duhet të mendohet dhe aplikimi i një tarife për depozitimin përfundimtar të mbetjeve në landfillin/incineratorin rajonal. Ashtu siç është sqaruar në kapitullin e vend- depozitimeve, në vitin 2026 duhet të përfundojë dhe afati i kontratës koncesionare për funksionimin e incineratorit/landfillit rajonal. Cilado qoftë mënyra e menaxhimit të këtij impianti (nga Qeveria Shqiptare apo nga bashkitë e qarkut, në formën e një sh.a.-je apo si ndërmarrje shtetërore) përsëri në këtë moment Bashkitë e Qarkut Fier do të jenë të angazhuara me pagesën e tarifës së depozitimit të mbetjeve në këtë impiant. Nuk mund të bëhet një parashikim i përafërt mbi nivelin e kësaj tarife pasi më parë duhet analizuar gjatë funksionimit në 6 vjeçarin e parë por gjithsesi për shkak të kësaj tarife bashkitë duhet të nxisin dhe ndërmarrin iniciativa për reduktimin e sasisë së mbetjeve që do çojnë në incineratorin/landfillin nëpërmjet kompostimit, riciklimit, etj.

Tabela 17 Programet dhe projektet e zhvillimit dhe plani i veprimit

N R.	Bashkia Mat	Faza I	Faza II	Faza III
I	Programi për përmirësimin dhe eficientimin e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Mat			
1	Projekti për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve të ngurta me anë të rritjes së numrit të kontenierëve dhe koordinimit të itinerareve në fshatrat e njesive Administrative Macukull, Derjan, Lis, Rukaj, Koms, Baz, Ulez			
2	Projekti për rinovimin e infrastruktures aktuale të grumbullimit të mbetjeve për përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi (investim në kontenierë dhe makina teknologjike).			
3	Projekti për hartimin e planit të fizibilitetit dhe implemtimin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonën Pilot të 2-3 fshatrave dhe një lagje në qytet me synim shtrirjen edhe në zonat e tjera me anë të metodologjisë së mbledhjes derë më derë			
4	Projekti për hartimin dhe implementimin e skemës së menaxhimit të mbetjeve spitalore dhe mbetjeve të rrezikshme.			
5	Projekti për hartimin dhe vënien në punë të platformës së monitorimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Mat			
6	Projekti për hartimin dhe impletmenimin e skemava individuale për menaxhimin e mbetjeve të bizneseve të medha.			
II	Programi për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturave për kryerjen e shërbimit të pastrimit të mbetjeve të ngurta me cilësi më të lartë me efekte minimale në mjedis në Bashkinë Mat			
7	Projekti për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe të ndërtimit të pikave të kompostimit të mbetjeve organike.			
8	Projekti për rehabilitimin mjedisor të vend-depozitimit aktual të mbetjeve në Bashkinë Mat dhe ndërtimin e pikës së magazinimit dhe të riciklimit të mbetjeve.			
9	Projekti për ndërtimin e pikave të kompostimit sipas rezultateve të studimit të fizibilitetit në Bashkinë Mat.			
10	Projekti për rehabilitimi mjedisor të pikave stacionare të hapura të grumbullimit të mbetjeve.			
III	Forcimi i menaxhimit financiar në kuadër të menaxhimit efektiv të shërbimit të pastrimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Mat			
11	Projekti për hartimin e planit të veprimit për vënien në punë të sistemit të tarifimit			

	progresiv.			
12	Projekti për hartimin dhe implementimin e nje programi elektronik për sistemin e tarifimit progresiv.			
13	Projekti për implementimin e tarifës progresive për ofrimin e shërbimit të menaxhimit dhe pastrimit të mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Mat.			
14	Projekti për hartimin e planit financiar të veprimit për aplikimin e tarifës së depozitimit përfundimtar.			
I V	Programi për sensibilizimin e komunitetet për menaxhimin efektiv të mbetjeve dhe për mbajtjen pastër të qytetit.			
15	Nxjtja e komunitetit për ndërmarrjen e iniciativave për reduktimin e sasive të mbetjeve me anë të proceseve të ripërdorimit, kompostimit dhe riciklimit të tyre nga komuniteti.			
16	Projekti për informimin e komunitetit dhe transparencën mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe rëndësinë e tij në territor.			

Burimi: Bashkia Mat; 2020

Në [Shtojca4](#) gjenden të listuar dhe detajet mbi projektet për Zgjerimin dhe Përmirësimin e Shërbimit e Menaxhimit të Mbetjeve, Menaxhimin e Diferencuar të Mbetjeve dhe për Forcimin e Menaxhimit Financiar.

SHTOJCA 1: HARTAT E PGM, SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE

Figura 23 Hartat e PGM NjA, Lis




Figura 24 Harta e PGM, NjA. Macukull




Figura 25 Harta e PGM, NjA. Rukaj




Figura 26 Harta e PGM, NjA.Ulëz




Figura 27 Harta e PGM, NjA.Baz




Figura 28 Harta e PGM, NjA. Derjan






Figura 29 Harta e PGM, NjA. Komsj



Burimi: CO-Plan, 2022


SHTOJCA 2: SKEMAT E PASTRIMIT TË RRUGËVE

Figura 30 Skema e Pastrimit të Rrugëve, Burrel



Burimi: CO-Plan, 2022



Figura 31 Sipërfaqet e Planifikuara për Pastrim në vitin 2022




Burimi: Bashkia Mat, Përpunoi: CO-Plan 2022

SHTOJCA 3: GRAFIKËT E MBULIMIT ME SHËRBIM TË POPULLSISË

Figura 32 Grafiku i Mbulimit me Shërbim të Popullsisë



Mbulimi me Shërbim i Popullsisë sipas RGJC



Burimi: Bashkia Mat, Përpunoi: CO-Plan, 2022

SHTOJCA 4 : FISHAT E PROJEKTEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Tabela 18 Fishat e Projekteve

Titulli i Projektit	Programi për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve me anë të rritjes së numrit të konteniereve dhe koordinimit të itinerareve në Bashkinë Mat.
Konteksti i Projektit	Në bashkinë Mat vërehen disa problematika të theksuara sa i përket menaxhimit të mbetjeve që kanë të bëjë me shtrirjen e këtij shërbimi në zona të caktuarara të bashkisë si dhe rinovim te infrastrukturave të tilla dhe nvojën për investime në kontenierë apo mjete teknologjike për përmirësimin e këtij shërbimi. Shumë zona në bashki kanë mungesë kontenierësh apo nuk preken nga itineraret e mjeteve të cilët bëjnë grumbullimin e mbetjeve. Në këtë situatë disa zona të bashkisë rrezultojnë problematike, të cilat kanë vend-depozitime josanitare të shpërndara në territor. Gjithashtu territori i Bashkisë nuk mbulohet në masën 100% të sipërfaqes nga ky shërbim.
Përshkrimi i Projektit	Programi synon ndërmarrjen e një sërë hapash konkret që kanë të bëjnë me evidentimin e zonave problematike sa i përket shërbimit të mbetjeve më pas mënyrën e ndryshimit në këto zona duke përmirësuar shërbimin qoftë merrijeten e numrit të koshave qoftë me rikoordinimin e itinerareve të grumbullimit të mbetjeve apo investimin në mjete teknologjike të reja. Në këto zona problematike nevojitet shtimi i konteniereve dhe rikoordinimi i itinerareve për grumbullimin e mbetjeve si masë në kuadër të përmirësimit të këtij shërbimi në Bashkinë Mat. Ky program përfshin si programe të veçanta projektet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Projekti për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve të ngurta me anë të rritjes së numrit të konteniereve dhe koordinimit të itinerareve • Projekti për rinovimin e infrastruktures aktuale të grumbullimit të mbetjeve për përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi (investim ne konteniere dhe makina teknologjike).
Partnerët	Bashkia Mat, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, donatorë të ndryshëm, kompanitë e rickilimit, shoqëria civile etj.
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti ndikon në rritjen e performancës së shërbimit të mbledhjes së mbetjeve në Bashkinë Mat duke mbuluar me shërbim të gjithë territorin. • Projekti ndikon direkt në rritjen pastërtisë së ambientit në zonat problematike. Projekti ndikon në rritjen e cilësisë së jetesës për banorët e Bashkisë Mat.
Objektivi	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve në zonat ku shërbimi i mbledhjes së mbetjeve nuk plotëson nevojat e komunitetit dhe rritja e performancës së këtij shërbimit në përgjithësi në Bashkinë Mat.
Veprimet Konkrete	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim vëndojse për 70 konteiner të rinj 1.1m³ me synim mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë. Vëndosja fizike në territor parashikuar nga plani. Shtimi me 10 km i intenerarit ekiztues për mbulimin e territorit ku do të shtohen konteineret e rinj. Inteneraret e shtuar parashikuar specifikisht nga plani. • Përpilimi termave të referencës për blerjen e një makine të re teknologjike me kapacitet mesatar. • Hartimi i një plani veprimi për zhvendosjen e mbetjeve në zonat problematike apo venddepozitimet e vogla jo sianitare drejt vend- depozitimit kryesor. • Instalimi i konteinerve për mbeldhje të diferencuar në shkollat kryesore të Bashkisë Mat. Menaxhimi i brëndshëm i mbetjeve dhe sigurimi i shitjes së tyre tek biznesi riciklimit apo ripërdorimi i tyre në një program të dedikuar mësimor. • Vlerësim ekonomik i të gjithë ndërhyrjeve të planifikuara mësipër. • Lobim i vazhdueshëm për fonde ne këtë sektor si edhe planifikimi në masën 70% të vlerës ekonomike në buxhetin e vitit 2022.

	Mirëmbajtje dhe monitorimi i shërbimit të mënaxhimit të mbetjeve në bashki.
Rezultatet e pritura	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e performancës së shërbimit të mbledhjes së mbetjeve në bashki • Rritje e cilësisë së ambientit dhe • Përmirësim i cilësisë së jetës së qytetarëve
Reziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia ska mundësi të shumta ekonomike për të financuar projektin, ndërsa donatorët të cilët financojnë projekte të tilla janë të pakët.
Faza e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Koncept-Projekt
Vlera e Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • 190 000 Euro
Përfundimi Zbatimit	<ul style="list-style-type: none"> • Afatshkurtër (1-2 vjet pas miratimit të planit)

Titulli i Projektit	Programi për menaxhimin e diferencuar të mbetjeve në Bashkinë Mat
Konteksti i Projektit	Në kuadër të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i cili jep incentiva për ngritjen e skemave menaxhimit të diferencuar të mbetjeve që në burim në rrallë të parë për uljen e kostove të shërbimit të mbledhjes së mbetjeve sidhe për rritjen e sasisë të mbetjeve të riciklueshme dhe të ripërdorimit si mall i për për industrinë e riciklimit. Në këtë kuadër Bashkia Mat do të ndërmerri si hapa të parë aplikimin e diferencimit të mbetjeve që në burim në zona pilot me synim në shtrirjen e tyre në të gjithë bashkinë në fazën afatgjatë
Përshkrimi i Projektit	<p>Programi synon hartimin e një plani veprimi dhe zbatimin e tij në kuadër të menaxhimit të diferencuar të mbetjeve në bashkinë Mat ky si hapa konkret do të jënë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonën Pilot të 2- 3 fshatrave dhe një lagjeje në qytet me synim shtrirjen edhe në zonat e tjera me anë të metodologjisë së mbledhjes derë më derë. <p>Support për frunizmi me kosha të rinj për diferencimin e mbetjeve.</p>
Partnerët	Bashkia Mat, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, donatorë të ndryshëm, kompanitë e riciklimit, shoqëria civile etj.
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Programi ndikon në rritjen e performancës dhe eficiencës së shërbimit të mbledhjes së mbetjeve në zonë. • Ndikon në uljen e kostove të shërbimit të pastrimit të mbetjeve të qytetit. • Rrit sasinë e mbetjeve të riciklueshme e cila shitet si mall i parë për industrinë e riciklimit <p>Redukton sasinë e mbetjeve për në venddepozitimin përfundimtarë.</p>
Objektivi	Përmirësimin i menaxhimit të mbetjeve duke kryer menaxhim të diferencuar të tyre në mënyrë që kostoja e këtij shërbimit të ulet dhe të rritet performanca e tij sidhe rritja e sasisë së ricikluar dhe të ripërdorimit të tyre.
Veprimet Konkrete	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi mercologjik i mbetjeve të prodhura nga kjo zonë • Zbatimit i analizave të hollësishme në zonë për benefitet e menaxhimit të diferencuar të mbetjeve. • Zbatimi i planit të veprimit dhe përfshirja në skemën e mënaxhimit të diferencuar të mbetjeve i aktorëve riciklues nëpërmje marrveshjeve kontraktuale. • Vlerësimi sasior dhe ekonomik i infrastrukturës së nevojshme. • Hartimi i incentivave mbështetëse dhe lehtësuese nga Bashkia Mat për banorët e kësaj zone pilot. • Sigurimi i fondeve për vendosjen e infrastrukturës mbështetëse në zonë. • Përpilimi dhe zbatimi i një fushate intensive 1 mujore sesibilizimi të komunitetit në lidhje me aplikimin e menaxhimit të diferencuar të mbetjeve në zonë <p>Monitorimi i skemave të mënaxhimit të diferencuar të mbetjeve</p>
Rezultatet e pritura	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i indikatorëve mjedisor (pastërti/ndotje) dhe perceptues si pasojë e rritjes së

	<p>përformancës së shërbimit në kaudër të diferencimit të mbetjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ulja e sasisë së mbetjeve te depozituara në vendepozitimin përfundimtarë. • Ulja e kostove të shërbimit të pastrimit të mbetjeve • Rritje e e sasive te mbetjeve te riciklueshme të cilat shërbejnë si mall i parë për industrinë e riciklimit.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti kërkon punë përgatitore te madhe e cila zgjatë në kohë si një projekt pilot i cili kërkon të zbatohet për të marrë parasyshë te gjitha rreziqet që paraqet menaxhimi i diferencuar i mbetjeve në kontekstin Shqipëtarë. • Është një projekt i cili kërkon fonde financiare te larta si dhe kapacitete menaxhuese të larta. • Projekti kërkon bashkëpunim të frytshëm me komunitetin dhe sensibilizimin e lartë të tij për të patur sukses në zhvillimin e skemave te • menaxhimit të diferencuar te mbetjeve.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera e Projektit	(për tu vlerësuar)
Përfundimi Zbatimit	Afatmesëm (3-4 vjet pas miratimit të planit)

Titulli i Projektit	Programi për forcimin e menaxhimit financiar, databazës me informacion e shërbimit dhe informimin të publikut në kuadër të menaxhimit gjithëpërfshirës dhe me efektiv të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Mat
Konteksti i Projektit	<p>Në kuadër të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe VKM Nr. 319, datë 31.05.2018 Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit Të Integruar të Mbetjeve Bashkitë incetivohet që të aplikojnë tarifa progresive në lidhje me shërbimin e pastrimit të mbetjeve ku konsumatorët ose abonentët paguajnë sipas sasisë së prodhuar të mbetjeve.</p> <p>Në këtë kontekst Bashkia Mat synon të aplikojë tarifimin progresiv për menaxhimin e mbetjeve .</p>
Përshkrimi i Projektit	<p>Programi synon ndërmarrjen e një sërë hapash konkret që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe aplikimin e zbatimit e tarifës progresive për menaxhimin e mbetjeve ku secili prej abonentëve paguan aq sa mbetje prodhon. Projekte nën këtë program synohen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti për hartimin e planit të veprimit për vënien në punë të sitemit të Tarifimit Progresiv. Projekti për hartimin dhe implementimin e një programi elektronik për sistemin e tarifimit progresiv. • Projekti për implementimin e tarifës progressive për ofrimin e shërbimit të menaxhimit dhe pastrimit të mbetjeve të ngurta urbane në bashkinë Mat. • Projekti për hartimin e planit financiar të veprimit për aplikimin e tarifës së depozitimit përfundimtar. <p>Ky program synon gjithashtu ndërtimin e një databazë të plotë e cila përditësohet në mënyrë sistematike me informacione të reja për abonentët të cilët marrin shërbimin e pastrimit të mbetjeve dhe informimin e publikut për të gjithë veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Mat.</p>
Partnerët	Bashkia Mat, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, , donatorë të ndryshëm, kompanitë e riciklimit, shoqëria civile etj.
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Programi ndikon në uljen e sasisë së mbetjeve te prodhuara nga konsumatorët. • Ndikon në përmirësimin e menaxhimit financiar të shërbimit te pastrimit te mbetjeve. <p>Ndikon në uljen e kostove të shërbimit të menaxhimit te mbetjeve në bashkinë Mat</p>
Objektivi	Rritja e performancës financiare e shërbimit të pastrimit të mbetjeve në kaudër të aplikimit të tarifimit progresiv në Bashkinë Mat.
Veprimet Konkrete	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i analizave financiare për shërbimin dhe vendosjen e tarifës për secilin targetgrup konsumatorësh në lidhje me sasinë e llojin e mbetjeve të prodhuara. • Përthitja e fondeve për palikimin dhe zbatimin e programit të tarifimit progresiv. • Hartimi i një plani veprimi për aplikimin dhe zbatimin e tarifës progresive për menaxhimin e

	<p>mbetjeve në Bashkinë Mat.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i Databazës së të dhënave monitorimi dhe përditësimi i saj me informacione. • Zhvillimi programit kompjuterik për llogaritjen dhe arkëtimet e kësaj tarife. • Informimi i publikut mbi menaxhimin e mbetjeve me anë të portalit online të Bashkisë Mat. Mirembajtja monitorimi dhe kontrolli i nivelit të akëtimeve dhe traifimit.
Rezultatet e pritura	<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e sasisë së mbetjeve të prodhuara në Bashkinë Mat • Rritje e cilësisë së ambjentit dhe pastërtia • Përmirësim i cilësisë së jetës së qytetarëve <p>Rritje e sensibilizimit e qytetarëve për menaxhimin e mbetjeve dhe për ambjentin.</p>
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia nuk ka kapacitetet e duhura ekonomike dhe njerzore për zhvillimin e këtij programi. • Nevojitet një bashkëpunim i frytshëm ndërmjet komunitetit dhe bashkisë për zhvillimin me sukses të këtij programi.
Faza e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Koncept-Projekt
Vlera e Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • 10,000-15,000 Euro
Përfundimi Zbatimit	<ul style="list-style-type: none"> • Afatmesëm (4-5 vjet pas miratimit të planit)

SHTOJCA 5: RIKUPERIMI I ENERGJISË (LËNDËT DJEGËSE ALTERNATIVE RDF DHE SRF)

Në relacionin më poshtë jepen shpjegime më të hollësishme në lidhje me:

- Çfarë është bashkë-përpunimi/bashkë-procesimi?
- Çfarë janë lëndët djegëse me prejardhje të refuzuar (RDF) / lënda e rikuperuar e ngurtë (SRF)
- Parimet e përgjithshme për bashkë-përpunimin/procesimin e mbetjeve
- Modeli i biznesit për suksesin e bashkëpërpunimit/procesimit:

RELACION

BASHKË-PËRPUNIMI DHE LËNDËT DJEGËSE ALTERNATIVE

1. ÇFARË ËSHTË BASHKË-PËRPUNIMI/BASHKË-PROCESIMI?

Bashkë-përpunimi i referohet përdorimit të disa fraksioneve të MNB si lëndë djegëse alternative (LDA) duke rikuperuar energji nga përpunimi i materialit të tyre. Pas një procesi të kujdesshëm përpunimi këto materiale mund të përdoren si lëndë djegëse në industrinë e prodhimit të çimentos ku temperatura në furrën e djegies i kalon 1,500°C, duke mundësuar asgjësimin e plotë të këtyre materialeve pa shkaktuar emetime të dëmshme në ajër.

Fraksione të caktuara të MNB pasi kane kaluar procesin e riciklimit dhe janë klasifikuar si mbetje të refuzuara, mund të digjen në temperatura të larta. Kësisoj çlirohet kapaciteti termik që bartin mbetjet e përpunuara, duke bërë të mundur rikuperimin e energjisë prej tyre.

Sasia e energjisë së prodhuar nga djegia e LDA nuk është fikse, por varet nga përbërja dhe lloji i mbetjeve të refuzuara të cilat vendosen për t'u përfshirë në këtë proces.

Bashkë-përpunimi (Co-Procesimi) është kombinimi i riciklimit të materialeve dhe njëkohësisht rikuperimit të energjisë nga mbetjet në një proces termik, i cili çon në zëvendësimin e burimeve natyrore minerale dhe lëndëve djegëse fosile si qymyri dhe produktet e naftës.

Për të maksimizuar proceset e rikuperimit, mbetejt e ngurta bashkiake (MNB) duhet të parapërpunohen përpara se të pranohen në ambientet e co-procesimit të tyre.

Duhet të ketë një fazë të përpunimit mekanik për MNB. MNB-të e papërpunuara së pari kontrollohen dhe trajtohen për të rikuperuar elementë të riciklueshëm, duke përfshirë metalet, plastika PET dhe kanaçe alumini (zbatimi rigoroz i përcaktimeve të hierarkisë së mbetjeve). Pastaj ndahen në mbetje për kompostim dhe mbetje inerte. Pjesa përfundimtare, fraksionet të cilat përbëjnë afërsisht 25% të peshës së MNB-të origjinale, më pas mund të bashkë-përpunohen/procesohen në furrat e dedikuara.

Në trajtimin mekanik të MNB që përfshin zvogëlimin e volumeve, copëtimi/grimcimi është një fazë thelbësore. MNB shpesh copëtohen/grimcohen në njësitë e trajtimit të mbetjeve me përmasai prej 200 deri në 250 mm.

Për shkak të kostove të larta të djegies/të incenerimit dhe faktit që reduktimi i CO₂ nuk e ndihmon procesin të përdorë më pak lëndë djegëse jo të rinovueshme, landfilli nuk është një zgjidhje miqësore me mjedisin.

Bashkëpërpunimi është pa dyshim zgjedhja më e mirë për mjedisin.

Bashkëpërpunimi siguron katër rezultate të rëndësishme:

- redukton intensitetin e CO₂ të gjeneruar nga lëndet djegëse fosile;
- redukton varësinë nga lëndët djegëse fosile të kushtueshme;
- redukton sasinë e mbetjeve të hedhura në landfille;
- ul kostot e shpenzimeve publike/bashkiake.

Bashkë-përpunimi/procesimi i mbetjeve bashkiake (MNB) mund të ndihmojë në adresimin e kërkesës në rritje për trajtimin dhe asgjësimin e këtyre mbetjeve, në mënyrë më të sigurtë dhe të përgjegjshme për mjedisin, duke reduktuar gjithashtu konsumin në rritje të lëndëve djegëse fosile dhe emetimet e dioksidit të karbonit (CO₂).

Konventa e Bazelit (2011) e përkufizon bashkëpërpunimin/procesimin si "përdorimin e materialeve të mbetjeve në proceset e prodhimit me qëllim të rikuperimit të energjisë dhe/ose burimeve dhe reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse konvencionale dhe/ose lëndëve të para përmes zëvendësimit".

Ky koncept është i lidhur ngushtësisht me një qasje sa më pozitive ndaj mjedisit, konkretisht me rolin që mund të ketë industria në reduktimin e ndotjes mjedisore gjatë gjithë ciklit jetësor të një produkti. Konventa e Bazelit e përcakton më tej bashkëpërpunimin/procesimin si një operacion "i cili mund të çojë në rikuperimin e burimeve, riciklimin, ripërdorimin e drejtpërdrejtë ose përdorime alternative".

Sipas të dhënave të Cembureau¹ (Shoqata Europiane e Çimentos), në vitin 2017 më shumë se 40 % e energjisë termike e përdorur për të furnizuar procesin e prodhimit të klinerit (çimentos) vjen nga mbetjet dhe biomasa.

Sipas këtyre të dhënave co-procesimi në industrinë e çimentos ka sjellë:

- Reduktimin me 18 milion ton çdo vit të emertimeve të CO₂;
- Përdorimi i lëndëve djegëse alternative, duke përfshirë dhe biomasën, kursen rreth 6.7 milion ton qymyr.
- Rreth 5 % e lëndëve të para të nevojshme në prodhimin e çimentos në Europë, përbëhen nga materiale të riciklueshme dhe hiri nga lëndët djegëse alternative.

Bashkë-përpunimi është një zgjidhje më efikase për menaxhimin e mbetjeve se depozitimi në landfill ose djegia në incenerator dhe do të thotë që industria e çimentos është konsumatori neto i mbetjeve dhe është në qendër të ekonomisë qarkulluese.

2. LËNDË DJEGËSE ME PREJARDHJE TË REFUZUAR (RDF) / LËNDA E RIKUPERUAR E NGURTË (SRF)

a) Lëndë Djegëse me Prejardhje të Refuzuar (RDF)

RDF-të janë lëndë djegëse ose ndryshe karburant i krijuar nga lloje të caktuara mbetjesh, të tilla si mbetjet e ngurta bashkiake dhe mbeturinat e tjera të djegshme.

Sipas ekspertëve nderkombetar, RDF-të i referohen ndarjes së fraksioneve me vlera të larta kalorifike të gjeneruara nga mbetjet bashkiake. RDF-të mbulojnë një gamë të gjerë materialesh mbetjesh (mbetjet nga riciklimi i materialeve të ngurta bashkiake (MNB), mbetjet industriale/tregtare, llumrat e ujërave të zeza, mbetjet e biomasës, etj.), të cilat janë përpunuar në mënyrë të posacme për të përmbushur udhëzimet, rregullat ose specifikimet e industrisë e cila mundt'i përdorë këto lëndë si energji kryesisht për të arritur një vlerë të lartë kalorifike të caktuar.

¹ <https://cembureau.eu/media/0s5dëpz3/16300-cembureau-ëhat-is-co-processing-2019-10-31.pdf>

Në rastin tonë studimor lloji i RDF-ve që mund të prodhohet dhe mund të përdoret nga Antea Cement kërkohet në formë peleti ose RDF push. Peleti RDF ose Fluff RDF është një lëndë djegëse alternative nga përpunimi i mbetjeve duke ndarë metalet, qelqin dhe materialet e tjera inorganike.

b) Lëndë e rikuperuar e ngurtë (SRF)

Termi "Lëndë e ngurtë e rikuperuar" (SRF) përdoret për të përcaktuar çdo lëndë djegëse detyësore e cila përmbush një standard të caktuar, si p.sh: CEN/TC 343, me një strukturë më homogjene, me karakteristika të standardizuara dhe të parashikueshme (Glorious, 2014). Lënda e rikuperuar e ngurtë (SRFs) janë një nëngrup i familjes së madhe të lëndëve me prejardhje nga refuzimi (RDF), i përbërë nga lëndë djegëse të përpunuara që plotësojnë kërkesat e cilësisë për nevojat ekonomike, teknologjike dhe mjedisore të përcaktuara sipas standardeve (p.sh., EN 15539 në Evropë ose JIS Z7311 në Japoni).

Lëndët e rikuperuara të ngurta (SRF) janë lëndë djegëse alternative të një cilësie të lartë të derivuara nga mbetjet komerciale, duke përfshirë letrën, kartonin, drurin, tekstilet dhe plastikën me një vlerë kalorifike midis 17 – 22 MJ/kg.

Prodhimi i lëndëve djegëse (RDF)² dhe (SRF)³ duhet të jenë nga mbetje të pa riciklueshme, në përputhje me Direktivën Kuadër për Mbetjet⁴, e cila përcakton kërkesat për të respektuar hierarkinë e mbetjeve të BE-së (neni 4) dhe për të siguruar që mbetjet e riciklueshme të grumbullohen dhe riciklohen veçmas dhe të mos digjen (neni 10). Rikuperimi i energjisë nga mbetjet e pa riciklueshme shmang depozitimin dhe është në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe objektivat e ekonomisë qarkulluese. Lëndët djegëse që rrjedhin nga mbetjet dhe që i nënshtrohen djegies ose bashkëdjegjes janë subjekt i kërkesave strikte të përcaktuara në Direktivën e Emetimeve Industriale (IED)⁵.

❖ Dallimi midis RDF dhe SRF

Termet RDF dhe SRF shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por i referohen lëndëve djegëse alternative me veti shumë të ndryshme:

- RDF me një vlerë kalorifike neto prej 8-14 MJ/kg (Megaxhaul për kilogram). Zakonisht janë mbetjet e mbetura të para-ndara dhe të copëtuara që hiqen aty ku është praktike, ose pjesa e refuzuar e një procesi pune nga një njësi ose pike stacionare e përpunimit të mbetjeve MRF (Material Recycling Facility);
- SRF prodhohet sipas një standardi të specifikuar nga impianti marrës dhe mund të prodhohet sipas specifikimeve të standarde evropiane të përcaktuara në CEN153591. Zakonisht ato derivojnë nga mbetjet komerciale dhe industriale (C&I) të klasifikuara paraprakisht ose mbetje nga aktivitetet MRF dhe zakonisht kanë një CV/vlerë kalorifike neto ose >15 MJ/kg.

c) Përparësitë

Përparësitë mjedisore të përdorimit të këtyre lëndëve alternativave të tilla si RDF në furrat rrotulluese në fabrikat e çimentos janë:

- Furra përdor temperatura të larta (1800-2000°C) duke dhënë kështu garancinë për djegjen e plotë të mbetjeve dhe prishjen e të gjithë komponentëve potencialisht të dëmshëm për mjedisin, si DTT, furanet, etj.;

²RDF është një lëndë djegëse e prodhuar nga trajtimi (p.sh., copëtimi dhe dehidratimi) i mbetjeve të ngurta.

³SRF është një lëndë djegëse e prodhuar nga mbetje jo të rrezikshme në përputhje me standardet e BE-së EN15359.

⁴Direktiva 2008/98/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 mbi mbetjet dhe shfuqizimin e disa direktivave, OJ L 312, 22.11.2008, f. 3–30.

⁵Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), OJ L 334, 17.12.2010, f. 17–119.

- Materiali RDF ka një trajtim të gjatë në furrë në temperatura mbi 1100°C, për shkak të gjatësisë dhe rrotullimit të ngadaltë të furrës;
- nuk ka mbetje të procesit të djegies; dmth, të gjithë përbërësit e karburantit të padjegur futen në klinker (lënda bazë e prodhimit të cimentos);
- mjedisi i reaksioneve alkaline brenda furrës rrotulluese kufizon emetimet;
- përdorimi i RDF-së jep mundësi për një investim racional të procesit/biznesit;
- për sa i përket emetimeve në ajër nuk ka ndryshime të rëndësishme në krahasim me përdorimin e lëndëve djegëse fosile.

3. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR BASHKË-PËRPUNIMIN/PROCESIMIN E MBETJEVE

Jo të gjitha mbetjet mund të bashkë-përpunohen në industri. Përbërja kimike e mbetjeve dhe e produktit përfundimtar (nje nga rastet me efektive është produkti i çimentos), si dhe ndikimi në mjedis, duhet të merren gjithmonë parasysh kur mbetjet zgjidhen për proceset e bashkëpërpunim/procesimit.

Prandaj, parimet e mëposhtme udhëzuese duhet të ndiqen për të siguruar zbatim të suksesshëm:

Parimi 1	<p>Bashkëpërpunimi/procesimi duhet të respektojë hierarkinë e mbetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpërpunimi/procesimi nuk duhet të ndërhyjë në përpjekjet për të reduktuar mbetjet dhe mbetjet nuk duhet të digjen nëse bashkia gjen mënyra më efikase dhe miqësore me mjedisin për t'i rikuperuar ato. • Bashkëpërpunimi/procesimi ofron një opsion rikuperimi të burimeve për menaxhimin e mbetjeve që është i qëndrueshëm për mjedisin, prandaj duhet parë si një element integral i menaxhimit bashkëkohor të mbetjeve. • Konventat e Bazelit dhe Stokholmit, si dhe çdo marrëveshje përkatëse ndërkombëtare mjedisore, duhet të respektohen gjatë bashkëpërpunimit/procesimit.
Parimi 2	<p>Emetimet shtesë dhe ndikimet negative në shëndetin e njeriut duhet të shmangen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emetimet në ajër nuk duhet të jenë më shumë se ato nga furrat aktuale që përdorin lëndë djegëse konvencionale në mënyrë që të minimizohen ose të reduktohen në minimum ndikimet e dëmshme të ndotjes në shëndetin e njeriut dhe mjedisit.
Parimi 3	<p>Cilësia e produktit duhet të mbetet e pandryshuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në rastet e përdorimit të LDA në fabrikat e cimentos ndalohet përdorimi i papërshtatshëm i produktit (klinker, çimento ose beton) si proces/produkt fundor për metalet e rënda. • Kryerja e detyrueshme e testimeve, në mënyrë që të verifikohet apo të kuptojmë që produkti nuk ka pasoja negative mjedisore. • Cilësia e çimentos duhet të lejojë rehabilitimin në fund të jetës.
Parimi 4	<p>Bashkitë/Kompanitë e përfshira në bashkëpërpunim/procesimit duhet të kualifikohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkitë/Kompanitë duhet të kenë të dhëna të sakta të pajtueshmërisë me mjedisin dhe sigurinë dhe të ofrojnë informacion përkatës për publikun dhe autoritetet përkatëse. • Bashkitë/Kompanitë duhet të kenë personel, procese dhe sisteme që demonstrojnë përkushtim për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë. • Bashkitë/Kompanitë duhet të respektojnë të gjitha ligjet, kushtet dhe rregulloret në fuqi. • Bashkitë/Kompanitë duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë inputet dhe parametrat e procesit për bashkëpërpunimin/procesimit sa më eficient të materialeve të mbetjeve.

	<ul style="list-style-type: none"> Bashkitë/Kompanitë duhet të sigurojnë marrëdhënie të mira me publikun dhe aktorë të tjerë në skemat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të mbetjeve.
Parimi 5	<p>Zbatimi i bashkëpunimit duhet të marrë parasysh rrethanat kombëtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkitë/Kompanitë duhet të demonstrojnë një histori të pajtueshmërisë mjedisore dhe të sigurisë dhe duhet të shpërndajnë informacionin përkatës tek publiku i gjerë dhe autoritetet përkatëse. Bashkitë/Kompanitë kanë nevojë për staf, procedura dhe sisteme që tregojnë një përkushtim për të mbrojtur shëndetin e njeriut, mjedisin dhe sigurinë. Bashkitë/Kompanitë janë të detyruara të respektojnë të gjitha ligjet, kushtet dhe rregulloret në fuqi. Për një bashkëpunim/procesim efektiv të materialeve të mbetjeve, grupet e interesit duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë inputet dhe parametrat e procesit. Bashkitë/Bizneset gjithashtu duhet të mbajnë marrëdhënie pozitive me publikun e gjerë dhe pjesëmarrësit e tjerë në skemat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të mbetjeve.

Përdorimi i mbetjeve bashkiake si lëndë djegëse alternative ose lëndë të para (LDA) në operacionet industriale për të nxjerrë materiale dhe energji prej tyre quhet procesi i bashkëpunimit/procesimit. Temperatura e lartë e furrave të çimentos (1800 °C) lejon asgjësimin efikas të shumë llojeve të mbetjeve pa lëshimin e ndonjë gazi të rrezikshëm në atmosferë (ndryshe nga inceneratorë të cilët nuk arrijnë temperaturë më shumë se 1000 °C). Kapaciteti nominal i prodhimit të impianteve modern (fabrika cimento) zakonisht kalon një milion ton në vit. Duhet midis 60 dhe 130 kg lëndë djegëse dhe 110 kWh energji elektrike për të prodhuar një ton çimento.

Bashkëpunimi/procesimi është një teknikë që është përdorur për të përfshirë lëndët djegëse alternative në procesin e prodhimit për të ulur kostot që lidhen me përdorimin e lëndëve djegëse fosile (burim jo i rinovueshëm).

4. MODELI I BIZNESIT PËR SUKSESIN E BASHKËPËRPUNIMIT/PROCESIMIT

Komponentët kryesorë të procesit të bashkë-përpunimit/procesimit në furrat e çimentos janë renditur si më poshtë. Faktorët e mëposhtëm përcaktojnë nëse bashkë-përpunimi/procesimi i RDF në fabrikat e çimentos është i realizueshëm:

PËR BASHKINË

Zërat e të ardhurave	Zërat e shpenzimeve
<ol style="list-style-type: none"> Çmimi i RDF i shitur tek fabrika e çimentos Fonde shtesë komunitare për depozitimin e mbetjeve 	<ol style="list-style-type: none"> Shpenzimet e marketingut Vlerësimi i kostos së analizave të laboratorit Magazinimi dhe trajtimi Çmimi i para-përpunimit të mbetjeve të veçuara RDF nga mbetjet e djegshme

PËR OPERATORËT E PPP

Zërat e të ardhurave	Zërat e shpenzimeve
<ol style="list-style-type: none"> Çmimi i shitjes së RDF tek fabrika e çimentos Tarifa shtesë nga bashkia drejt procesit të konvertimit të RDF. 	<ol style="list-style-type: none"> Shpenzimet e marketingut Vlerësimi i kostos së analizave të laboratorit,

	<ul style="list-style-type: none"> c) Trajtimi dhe ruajtja d) Kostoja e përpunimit paraprak për konvertim të tjetër të djegshme të ndara në RDF e) Kostoja e amortizimit – mirëmbajtjes së impiantit
--	---

PËR FABRIKËN E ÇIMENTOS

Zërat e të ardhurave	Zërat e shpenzimeve
<ul style="list-style-type: none"> 1. Tarifat/taksat e fabrikës së /Operatori PPP 2. Përfitimi i zëvendësimit që rrjedh për shkak të zëvendësimit të lëndëve të para dhe lëndëve djegëse tradicionale me LDA. 	<ul style="list-style-type: none"> a) Koordinimi i tregut b) Çmimi i blerjes së LDA/RDF c) Vlerësimi i kostos së analizave të laboratorit d) Trajtimi dhe ruajtja e) Përpunimi paraprak f) Bashkëpërpunimi/procesimi g) Ndikimi në prodhim për shkak të lagështirës, hirit, klorit etj. h) Rritja e konsumit tradicional të karburantit i) Kostot e amortizimit - mirëmbajtjes etj.

Realizimi i këtij procesi synon prodhimin e LDA dhe tregtimin e tyre tek fabrikat e çimentos si një blerës potencial dhe që ka një konsum shumë të lartë vjetor të lëndëve djegëse fosile. Blerës potencial të tjetër mund të jenë edhe impiante të tjera të ngjashme, furrat e të cilave operojnë me temperatura më të larta se 1500 °C.

Politikat e BE po fuqizojnë akoma dhe më shumë reduktimin e emetimeve të CO₂ gjë e cila do të sillte përmirësim të kushteve mjedisore dhe gjithashtu përmirësim të situatës së menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin.

Çmimi i RDF/SRF në varësi të karakteristikave dhe fuqisë kalorifike përkatëse ndryshon sipas referencave në tregun përkatës. Aktualisht çmimi varion nga 20-35 euro/ton⁶ përkatësisht për RDF dhe SRF. Vlera reale përcaktohet sipas marrëveshjeve të drejtpërdrejta tregtare ndërmjet subjekteve prodhuese dhe atyre që e perdorin atë si LDA.

⁶ Market Analysis & Literature Review on Refuse Derived Fuel (RDF) from Residual Waste, 2021